

30 vjet
DRITA ISLAME



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 01 (468)
Janar, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- 4 30 Vjet “Drita Islame” / Dorian Demetja
- 6 “Drita Islame”, si mjet i përgjegjshëm komunikimi masiv në trendin e zhvillimeve aktuale / Ramadan Çipuri
- 10 Lajme / Aktivitete




- 14 Përse myslimanët duhet të jenë vëllezër? / Haki Sahitaj
- 16 Profeti Lut (a.s.) / Taulant Bica
- 18 Dhuroji vetes një fund të lumtur / Qani Sulku
- 20 “Drita Islame”- një shkëndijë e dritës së fesë islame në Shqipërinë paskomuniste / Qani Nesimi
- 24 Motivimi tek fëmijët / Aisa Kokçi
- 26 Misvaku – ilaç preventiv për dhëmbët



- 28 Ymer Saraçi – Personalitet / Xhemal Balla
- 30 Xhamia e Muradies, Vlorë / Aleksander Meksi
- 32 Roli i “Dritës Islame” në ndërgjegjësimin e gruas / Fatma Karaj
- 34 Sheqer apo yndyrë? / Erion Sukaj
- 38 Pika që shpëtoi një njeri / Hajri Shehu





30 vjet
DRITA ISLAME

Në vitin 1967, Shqipëria u shpall shteti i parë ateist në historinë e njerëzimit, i cili kulmoi me aksionin e madh për çrrënjosjen e xhamive e kishave, duke i sjellë vendit një dëm të dyfishtë edhe për vlerat e pazëvendësueshme kulturore, historike e arkeologjike të këtyre objekteve. Nëpërkëmbja e të drejtave minimale demokratike e humanitare të qytetarit, zgjati gati pesë dekada. Me rënien e sistemit komunist, me ndihmën edhe të popujve miq, Shqipëria u integrua në pluralizëm. Më 1990, u rivendos liria e fesë. Institucioni i Komunitetit Mysliman, i sapongritur, paralelisht me punën e hapjes së xhamive, duke vlerësuar situatën, e pa si nevojë të ngutshme nisjen e botimeve, ku i jepej përparësi shtypit periodik.

Ka qenë traditë e kahershme që institucionet përfaqësuese të komuniteteve fetare, të kenë mjetet e tyre të komunikimit masiv, kryesisht ato të shkruara në formën e gazetës dhe revistës, si dhe së fundmi të radiove, faqeve të internetit, rrjeteve sociale, etj. Me datë 7.10.1991 H. Hafiz Sabri Koçi i drejtohet Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve me një shkresë, ku mes të tjerave, i kërkon të mundësojë botimin e një gazete.¹ Ish-redaktori i gazetës "Drita Islame", z. Nasuf Dizdari kujton: "Ishin ditët historike të vitit 1991, kur në muajin dhjetor bëhej mbledhja e parë e Drejtorisë së Kulturës dhe u vendos që në janar të vitit 1992 të shihte dritën e botimit gazeta "Drita Islame", organ i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, si periodik dyjavor". Dhe kështu, me shumë përpjekje, më 10 janar 1992, doli numri i parë i gazetës "Drita Islame" dhe si kryeredaktor u caktua Ismail H. Muçej. Në numrin e saj të parë u botua edhe përshëndetja e kryetarit të Komunitetit Mysliman të asaj kohe, H. Hafiz Sabri Koçi me titull: "Mirë se na erdhe, Drita Islame!". Në sajë të një pune serioze e profesionale, shumë shpejt ajo u kthye në tribunën e mendimit islam dhe burimin kryesor të informacionit për myslimanët e Shqipërisë e përtej saj.

Autorë të kudondodhur nëpër Shqipëri, i rriten pretendimet ndaj artikujve të tyre, për t'u paraqitur me tematikë të larmishme çdo herë më të përmirësuar. Dinamika e zhvillimit në drejtim të cilësisë së shkrimeve, u orientua në kahun e prosperitetit, së bashku me zgjerimin e rrethit të bashkëpunëtorëve. Përmbajtja e gazetës karakterizohej jo vetëm nga botimi i mesazhit islam për një popull të etur për besim, por përmes analizave, sugjerimeve dhe kritikave të ndryshme, ka funksionuar edhe si një zë i elitës myslimane me besimtarët, shtresat e shoqërisë dhe institucionet publike e private, të gjitha këto në lidhje me çështje të nxehta që prekjin realitetin shqiptar. Që në numrin e parë, gazeta shpalosi misionin e saj shoqëror dhe kombëtar, ku synonte zgjimin e ndërgjegjes fetare te besimtarët e saj në bazë të mësimave morale të Kur'anit, duke e zhveshur nga të gjitha mbresat e dëmshme të lëna nga ateizmi për afro gjysmë shekulli.

Në një moment kur Shqipëria po përballlej me një nga krizat më të mëdha të periudhës paskomuniste, atë të

firmave piramidale në vitin 1997, KMSH, përmes "Drita Islame", sqaroi pozicionin e saj ndaj kësaj çështjeje, duke i ofruar çdo besimtar të vërtetën islame ndaj kamatës apo fajdesë: "Si fe humanitare që është, Islami e ndalon marrjen e interesit përkundrejt një huaje të dhënë dhe e konsideron atë si një akt që shkon në kundërshtim me atributin e Zotit"², thuhet në një editorial të posaçëm të publikuar në shkurt të 1997-ës.

"Drita Islame" e filloi veprimtarinë e saj fillimisht si gazetë deri në vitin 2011, për të vazhduar më pas në formatin e një reviste në janar të vitit 2012. Ajo nëpërmjet mesazheve që përcjell, përmbledh jo vetëm spektrin fetar, por trajton edhe një sërë çështjesh problemore që kanë të bëjnë me edukimin, ekonominë, normat e sjelljes komunitare, çështje me karakter social e politik, etj. Nga një vështrim i thjeshtë që mund t'i bësh çdo numri të gazetës/revistës, vihet re një larmi e gjerë analizash mbi çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me besimin, artin, kulturën, kombin, etj. Mjafton të shfletosh faqet e saj dhe që nga viti 1992 e deri më sot, do të gjesh tema të shumëllojshme, të cilat synojnë lexues të profesioneve, etnive dhe besimeve të ndryshme. "Drita Islame" ka edhe një meritë tjetër, atë të kujdesit të posaçëm që ka treguar për të respektuar arritjet bashkëkohore të gjuhës sonë me komponentët e saj, që ne e konsiderojmë si një kontribut me vlerë në drejtim të kulturës gjuhësore në të shkruar, pse jo, edhe në të folur.

Revista "Drita Islame" vjen në formatin online me adresën www.dritaislame.al, me një vizion të ri dhe me ambicie të reja në hapësirën mediatike shqiptare. Formatin online i "Dritës Islame" u hap më 1 dhjetor 2011 me informacione të ndryshme për të gjithë lexuesit, me një larmishmëri rubrikash si: Kur'an, hadith, fikh, bota jonë, refleksione, familja, gruaja, hapësirë fëmijore, trashëgimi kulturore, jeta e profetëve, jeta e profetit Muhamed (a.s.), jeta e sahabëve, histori fetare, fakte shkencore, personalitete, si dhe vetë formati i revistës në 'pdf'.

Në 25 vjetorin e saj, më 28 shkurt 2017, ish Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Bujar Nishani, i ka akorduar revistës "Drita Islame" titullin "Naim Frashëri" me motivacion: "Për kontributin e saj në zgjimin e ndërgjegjes fetare e kombëtare, me anë të promovimit të atdhedashurisë, harmonisë, mirëkuptimit, kulturës e vlerave humane të besimit Islam në mbarë kombin shqiptar".

Në këtë fillimvit, "Drita Islame" mbushi 30 vjet veprimtari të jetës në shërbim të myslimanëve dhe të të gjithë qytetarëve të kombit tonë, pa dallim ngjyre, religjioni apo shtrese shoqërore. Kontributi dhe arritjet e "Drita Islame" nuk mbarojnë këtu, veprimtaria e saj është mirëpritur nga vetë lexuesit. Me rastin e 30 vjetorit të organit të shtypit "Drita Islame", vëmendje të posaçme e përgëzime, meritojnë të gjithë ata që, për të paraqitur idealet, mendimet apo rezultatet e kërkimeve të tyre studimore, zgjodhën "Drita Islame".

1. Shkresa me nr. prot. 142, datë 7.10.1991, arkivi i KMSH.

2. Drita Islame, 1997, "Kamata apo fajdeja sipas Islamit", Shkurt: 1.




NË FOKUS

I RAMADAN ÇIPURI



Botim i Komunitetit Myslim



DRITA ISLAMË

Botim i Komunitetit Myslim



DRITA ISLAMË

“Drita Islame”

**SI MJET I PËRGJEGJSHËM
KOMUNIKIMI MASIV NË TRENDIN
E ZHVILLIMEVE AKTUALE**



Humbja e kufijve hapësinorë dhe kohorë, sidomos në një kohë kur e gjithë bota ndodhet nën ndikimin e stereotipave të shumtë, që mund të rrezikojnë ekuilibrat e brishtë që kanë ekzistuar dikur, por që sot shfaqen të ekspozuar ndaj mundësisë për të dështuar, duket se i kanë dhënë një tjetër dimension medias tradicionale. Sidomos, me zhvillimin e mediave të reja, kjo ka përparuar akoma më shumë, duke ofruar platforma komunikimi akoma më të mëdha, zhvillim ky që studiues të ndryshëm e vlerësojnë si fuqi prej pushteti “të pestë”, që media zotëron në ditët e sotme. Përgjegjësia e këtyre mjeteve të komunikimit masiv fiton gjithnjë e më shumë rëndësi në kushte të tilla, ku përmes një dritareje të vetme në Internet, mediumi arrin të mbërrijë te çdo qytetar global, tek të cilët mund të ndikojë në edukimin dhe në opinionin e tyre, në qasjet që ata mund të kenë ndaj situatave, konflikteve dhe zhvillimeve të kohës.

Rëndësia është akoma më e madhe kur flitet për çështje të ndjeshme, që vënë përballë njëri tjetrit komunitete, kultura, ideologji dhe hapësira të mëdha gjeografike, të cilat formësohen nga besimi fetar, element ky që lidhet drejtpërsëdrejti me “gjuhën e zemrës” dhe që mund të reflektojë dhe ndikojë më shumë se gjithçka tjetër në komunikimin dhe reagimin qytetar. Në këtu punim do të analizohet rasti i gazetës, së fundmi prej disa vitesh revistës “Drita Islame”, si një mjet i rëndësishëm shtypi i Komunitetit Mysliman Shqiptar (KMSH), mënyra se si ajo ka pasqyruar aktualitetin lokal dhe global nën misionin e një mediumi fetar të përgjegjshëm, si edhe përshtatja e saj me zhvillimet bashkëkohore të sektorit të medias.

Qasja e analizës është kryesisht cilësore, e mbështetur në një vështrim të detajuar të përmbajtjes së publikuar nga viti 1992 e deri më sot.

2. Tipare të rrugëtimit 30 vjeçar të gazetës – revistës “Drita Islame”

2.1. “Drita Islame” si zë publik i KMSH

Ka qenë traditë e kahershme që institucionet përfaqësuese të komuniteteve fetare të kenë mjetet e tyre të komunikimit masiv, kryesisht ato të shkruara në formën e gazetës, revistës, buletineve, etj., si dhe së fundmi të radiove, faqeve të internetit, etj. Drita Islame, ishte i pari organ shtypi zyrtar i KMSH-së pas rënies së regjimit totalitar, i cili duke nisur nga janari i vitit 1992 doli në mënyrë periodike çdo dy javë. Përmbajtja e gazetës karakterizohej jo vetëm nga botimi i mesazhit islam për një popull të etur për besim, por përmes analizave, sugjerimeve dhe kritikave të ndryshme ka funksionuar edhe si një zë publik dhe elitar i klerit mysliman me besimtarët, shtresat e shoqërisë dhe institucionet publike e private, të gjitha këto në lidhje me çështje të nxehta që preknin realitetin shqiptar. Që në numrin e parë, gazeta shpalosi misionin e saj shoqëror dhe kombëtar, ku “synonte zgjimin e ndërgjegjes fetare në besimtarët e saj në bazë të mësimave morale të Kur’anit, duke e zhveshur nga të gjitha mbresat e dëmshme të lëna nga ateizmi për afro gjysmë shekulli.”[1]

Siç ka vijuar edhe më vonë, me raste të ngjashme, në numrin e dytë të saj “Drita Islame” solli në vëmendje të opinionit publik dhe institucioneve shtetërore rëndësinë e pronave që KMSH kishte gëzuar dikur. Kështu përmes titullit “Një e drejtë që duhet rikthyer”, “Drita Islame” që në fillim mbajti qëndrim ndaj pronave të KMSH-së, ku në krye të një liste të detajuar të pronave të dikurshme, do të shkruante se “në mjaft rrethe të vendit tonë, Komuniteti Mysliman ka patur para çlirimit prona vakëfnore, të cilat përbëheshin nga dyqane, shtëpi banimi, hotele, hane, troje, ullinj dhe toka bujqësore”[2].

Në një moment kur Shqipëria po përballlej me një nga krizat më të mëdha të periudhës paskomuniste, atë të firmave piramidale në vitin 1997, KMSH përmes “Drita Islame” sqaroi pozicionin e saj ndaj kësaj çështjeje, duke i ofruar çdo besimtari të vërtetën islame ndaj kamatës apo fajdesë. “Si fe humanitare që është, Islami e ndalon marrjen e interesit përkundrejt një huaje të dhënë dhe e konsideron atë si një akt që shkon në kundërshtim me atributin e Zotit”[3], thuhet në një editorial të posaçëm të publikuar në shkurt të 1997-ës.

Përmes “Drita Islame”, KMSH ka bërë zyrtare edhe qëndrimin e tij ndaj terrorizmit dhe akteve terroriste, që duke nisur nga mesi i viteve ‘90, shumëkush i atashoi ato me Islamin. Kështu, disa tituj të botuar në mënyrë periodike gjatë këtyre viteve janë “Islami nuk është sinonim i

terrorizmit” (nëntor, 1995), “Islami është kundër dhunës dhe terrorit” (prill, 1997), “Zhurma e shtypit mbi terroristët islamikë” (shtator, 1998), poezia “Nuk jemi terroristë, o botë, pa feniksë të këtij ar(b) dheut” (tetor 1998), duke vijuar më tej me artikuj të ngjashëm pas vitit 2000 me “Keqkuptimet ndaj Islamit dhe lufta kundër terrorizmit” (dhjetor, 2002), “Terrori nga këndvështrimi islam” (nëntor, 2003), etj. Situata është pothuajse e njëjtë edhe në vitet e fundit, ku në “Drita Islame” gjenden qëndrime të drejtuesve të KMSH në lidhje me çështjen në fjalë, por edhe problematika të tjera që shqetësojnë vendin tonë.

2.2. “Drita Islame” si një mjet i marrëdhënieve me publikun

“Drita Islame” nuk ka qenë thjesht një gazetë apo një revistë që botohej nga KMSH në formën klasike që ne jemi mësuar t’i njohim organet e shtypit fetar. Ajo ka qenë një dritare komunikimi midis institucionit më të lartë mysliman në vend me publikun në tërësi. I intervistuar në kuadër të këtij punimi, Alban Tartari, studiues i medias dhe komunikimit, e vlerëson “Drita Islame” si një mjet të rëndësishëm të marrëdhënieve publike të KMSH-së me komunitetin vendas e më gjerë, mysliman dhe jo vetëm, etj.

Në kushtet e reja të zhvillimeve në sektorin e medias dhe komunikimit, redaksia e “Drita Islame” ka ditur më së miri të përshtatet me këto risi. Në përmbajtjen e botuar në print, por edhe në faqen e saj online, gjen jo pak artikuj, analiza dhe mesazhe të ndryshme që synojnë lexues që i përkasin një grupi gjithnjë e më shumë heterogjen në tiparet karakterizuese. Njohja e mirë e publikëve dhe audiencave vlerësohet si një çelës suksesi në fushën e marrëdhënieve publike.

E veçanta këtu qëndron në atë se “Drita Islame” ka arritur që t’i flasë jo vetëm publikut tradicional, që ne jemi mësuar të njohim, por të ashtuquajturve në shkencat e komunikimit si “publikë”, pra lloje të ndryshme publikësh brenda dhe jashtë vendit tonë. Sipas Alban Tartarit, studiues dhe specialist i komunikimit, “në termin ‘publikë’, në këtë rast nuk hyjnë vetëm besimtarët myslimanë, por edhe njerëz që nuk janë pjesë e këtij komuniteti, njerëz që nuk besojnë, apo që janë besimtarë por që nuk e praktikojnë besimin islam. Përmes natyrës së këtij lloji informacioni, “Drita Islame” ka synuar shoqërinë në përgjithësi, e veçanërisht publikët potencialë që mund të ndjekin mesazhin e saj.”[4]

Mesazhi i përcjellë nga “Drita Islame” është jo vetëm ai fetar, por trajton një sërë çështjesh problemore që kanë të bëjnë me edukimin, ekonominë, normat e sjelljes komunitare, çështje

me karakter social e politik, etj. Mjafton të shfletosh faqet e gazetës/revistës dhe që nga viti 1992 e deri më sot gjen tema nga më të larmishmet, të cilat synojnë lexues të profesioneve, etnive dhe besimeve të ndryshme.

2.3. "Drita Islame" si një manual mbi çështjet e besimit

Gazeta/revista "Drita Islame" i ka shërbyer besimtarëve myslimanë shqiptarë për të gjetur përgjigje në lidhje me çështjet e besimit. Ajo ka shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për gjëra nga më themeloret e deri në çështje të komplikuar të besimit.

Kjo gjë ka qenë mjaft e rëndësishme sidomos gjatë viteve 1990, ku shqiptarët vinin nga një shkuar që u kishte fshirë çdo informacion dhe orientim mbi jetën fetare. Përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve kanë ardhur në mënyrë periodike varësisht problematikave më të rëndësishme të kohës, si p.sh. "Jo besimeve të kota" (shkurt, 1992), "Familja – e vetmja vatër e lumturisë" (shkurt 1994), "Familja – bazë e një edukimi të shëndoshë për të rinjtë" (dhjetor, 1997), "Islami nuk është sinonim i terrorizmit" (nëntor, 1995), "Zhurma e shtypit mbi terroristët islamikë" (shtator 1998), "Fikhu – Sunneh – Legjislacioni i Traditës Profetike" (qershor, 2005), "Argumentet mbi namazin e teravive" (shtator, 2008), por edhe shumë çështje të tjera që kanë pasur të bëjnë me zhvillimet e nxehta globale që kanë nxitur konflikte të gjera.

2.4. "Drita Islame" si një bazë arkivore e mendimit islam në Shqipëri

Dalja e "Drita Islame" në një periudhë mjaft të rëndësishme për popullin shqiptar, analiza që u është bërë situatave të ndryshme, në momente të rëndësishme, përmes të cilave ka kaluar Shqipëria dhe këshillat fetare, që kanë ndihmuar besimtarët myslimanë shqiptarë, do të shërbejnë si një bazë e rëndësishme të dhënash arkivore për grupet e studiuesve në të ardhmen. Për 25 vjet me radhë, "Drita Islame" ka dokumentuar ngjarjet më të rëndësishme që kanë shoqëruar tranzicionin shqiptar të kësaj periudhe, u ka dhënë përgjigje pyetjeve dhe shqetësimeve të besimtarëve myslimanë rreth çështjeve të caktuara, ka qenë një zë zyrtar i KMSH-së ndaj zhvillimeve të rëndësishme etj., duke u kthyer kështu në një burim të rëndësishëm të dhënash për të ardhmen.

Në këtë aspekt, për t'u vlerësuar mbetet puna e bërë nga Drejtoria e Kulturës së KMSH-së, e cila ka arritur të digjitalizojë të gjitha ato përmbajtje të shtypura, si edhe të mbledhin në mënyrë të detajuar çdo titull të sjellë përmes gazetës/

revistës. Në vitin 2015, nën kujdesin e Kryetarit të KMSH-së, H. Skënder Bruçaj, Drejtoria në fjalë përmes një përmbledhjeje prej rreth 500 faqesh ka arritur të dokumentojë të gjithë bibliografinë e gazetës "Drita Islame" nga viti 1992 deri në vitin 2011[5].

E gjitha kjo është një punë për t'u lavdëruar, e ngjashme me përmbledhjen e bërë në formën e një kolane gjithëpërfshirëse të gjithë numrave të revistës "Zani i Naltë" midis viteve 1923-1939, e cila sot është kthyer në një thesar të dhënash mbi qasjet e asaj kohe ndaj zhvillimeve socio-ekonomiko-politike në vend.

2.5. "Drita Islame" si një medium elitare

Në kushtet kur njerëzit po i largohen gjithnjë e më shumë librit dhe letrës, duke iu drejtuar burimeve alternative të informimit përmes rrjetit, gazeta dhe revista mbeten mjete komunikimi për vetëm një grup të caktuar më dashamirës ndaj informacionit. Duke kuptuar këtë trend dhe veçori të revistës, drejtuesit e KMSH-së dhe të "Drita Islame" e kthyen këtë të fundit nga një gazetë periodike në një revistë të rëndësishme që ndikon në ndërtimin e opinionit publik, duke iu drejtuar disa shtresave më elitare. Nga një vështrim i thjeshtë që mund t'i bësh çdo numri të revistës, vihet re një larmi e gjerë analizash mbi çështje të ndryshme, që kanë të bëjnë me besimin, artin, kulturën, ekonominë, kombin, etj. "Drita Islame" është kthyer në një udhëzues për shumë njerëz të mirë edukuar, të cilët gjejnë aty analiza të shkruara nga emra të njohur shqiptarë dhe jo vetëm.

2.6. "Drita Islame" ndjek hapin e kohës edhe në Internet

Duke nisur nga nëntori i vitit 2011, "Drita Islame" nisi publikimin e saj edhe përmes internetit. Në këtë mënyrë, ajo u bë pjesë e pozicionimit të medias si një pushtet i pestë në shoqëri, ku përmes kanaleve virtuale arriti të komunikojë me lexues përtej çdo kufiri kohor apo hapësinor.

Përmes një dizajni mjaft të kuruar, përmes adresës zyrtare të saj www.dritaislame.al, ajo përcjell te vizitorët jo vetëm informacion fetar mbi Kur'anin, Hadithin, çështjet shpirtërore, por edhe zhvillime nga vendi, bota, rajoni, myftinitë, tematika sociale mbi shoqërinë dhe familjen, risi e kuriozitetet, etj.

Së fundmi, në vend të përfundimeve duhet theksuar se gazeta/revista "Drita Islame" është një medium i rëndësishëm, i cili përmbush suazën e shtypit fetar në Shqipëri. Ajo i vjen në ndihmë të gjithë besimtarëve myslimanë shqiptarë, dhe jo vetëm.



1

ZHVILLOHET MBLEDHJA E RADHËS ME MYFTINJTË E VERIUT TË SHQIPËRISË

Në ambientet e xhamisë "Riza Bajrami" në Durrës, u zhvillua mbledhja e radhës me myftinjtë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, të cilët mbulojnë kryesisht veriun dhe një pjesë të Shqipërisë së mesme.

I pranishëm në takimin me ta ishte Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Kancelari i Institucionit, z. Ylli Cikalleshi, Nënkrjetari, z. Taulant Bica dhe Drejtori i Vakf-Investimeve dhe Financës, z. Edison Hoti.

Kjo mbledhje u hap me leximin e disa ajeteve Kuranore nga imami i xhamisë, z. Kadim Rufati, për të vijuar më tej me fjalën hapëse të Kryetarit Spahiu, i cili u ndal në aktualitetin e 6-mujve të fundit të institucionit si dhe theksoi mbështetjen e ndërsjelltë që duhet të karakterizojë marrëdhënien mes myftinive dhe institucionit.

Më tej, fjalën e mori Kancelari i KMSH-së, z. Cikalleshi, Nënkrjetari, z. Bica, Dhe Drejtori i Vakf-Investimeve dhe Financës, z. Hoti, të cilët u fokusuan në çështje të ndryshme fetare dhe administrative.



2

FIRMOSET MARRËVESHJA PËR 154 BURSA STUDIUMI PËR NXËNËSIT E MEDRESEVE

H. Bujar Spahiu, kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe Ing. Ahmed bin Ali el-Biz, zv. Mbikqyrës i Lartë i Qendrës Bamirëse e Humanitare "Mbreti Selman", me qendër në Mbretërinë e Arabisë Saudite, firmosën marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet KMSH-së dhe Qendrës "Mbreti Selman" për financimin e bursave shkollore për nxënës jetimë dhe nevojtarë në medresetë e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Projekti në fjalë do t'u vijë në ndihmë 154 nxënësve në medresenë e Tiranës dhe atë të Elbasanit, duke u mbuluar atyre të gjitha shpenzimet shkollore për vitin shkollor 2021-2022, dhe duke u lehtësuar kështu barrën e shpenzimeve familjeve të tyre.

Ky bashkëpunim vjen në kuadër të marrëdhënieve të shkëlqyera dhe bashkëpunimeve të njëpasnjëshme ndërmjet dy institucioneve, fokus i të cilave ka qenë mbështetja e shtresave në nevojë në vendin tonë si dhe ndarja e vizionit të përbashkët rreth rëndësisë së arsimit të brezave të rinj.

3

MBLIDHET KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË

Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë zhvilloi me datë 04.12.2021, në ambientet e Medresesë së Tiranës, mbledhjen e fundit për vitin 2021.

Kjo mbledhje u çel me leximin e disa ajeteve Kur'anore, për të vijuar më tej me fjalën hapëse të kryetarit, H. Bujar Spahiu, i cili pasi përshëndeti të gjithë anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, u ndal në ecurinë e aktivitetit fetar të KMSH-së, intensifikimin e marrëdhënieve me jashtë, kryesisht ato më botën arabe dhe perëndimin.

Pas fjalës së kryetarit, kancelari, z. Ylli Cikallesi, bëri një rezymë përpara anëtarëve të këshillit, ku ndër të tjera detajoi në përshkrim të veçantë të gjitha vendimet e marra që nga mbledhja e fundit e KP-së.

Më tej u hodhën në votim raporti i kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm, raporti dhe vendimet e kryesisë së KMSH-së, akt-kontroli për periudhën 2020-2021 dhe miratimi i shpenzimeve për periudhën 2020-2021.





4

ZHVILLOHET ASAMBLEJA E 8-TË E FORUMIT PËR PROMOVIMIN E PAQES NË SHOQËRITË MYSLIMANE NË ABU DHABI

“Qytetaria Gjithëpërfshirëse - Nga bashkëjetesa e ndërsjelltë në ndërgjegjen e përbashkët” – është kjo tema e Asamblesë së 8-të e Forumit për Promovimin e Paqes në Shoqëritë Myslimane, e cila filloi punimet e saj më 5 Dhjetor në Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe.

Kjo asamble mbledhi së bashku përfaqësues fetarë nga vende të ndryshme të botës, studiues dhe akademikë, myslimanë, katolikë dhe hebrej.

Si përfaqësues të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë ishin të pranishëm Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli dhe Drejtori i Kabinetit, z. Ejup Lila.

Në kuadër të kësaj vizite, Myftiu Luli, zhvilloi një sërë takimesh me personalitete të ndryshme të botës Islame, me synimin për të intensifikuar më tej marrëdhëniet ndër institucionale.

5

FRYTET E BESIMIT NË XHAMINË SULEJMAN PASHËS, ELBASAN

Frytet e besimit, më datë 16.12.2021, u ndalën pas namazit të akshamit në xhaminë e “Sulejman Pashës” në qytetin e Elbasanit, ku ishin të pranishëm Nënkrjetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Myftiu i Elbasanit z. Agim Duka dhe Këshilltari i Kryetarit për Botën Arabe, z. Jamal Seferty.

Programi filloi me leximin e disa ajeteve Kuranore nga hafizi Enes Hyka, për të vazhduar më tej me trajtimin e temave të ndryshme fetare nga të lartëpërmendurit.





6

AKTIVITETI “MYFTINIA TIRANË NË 365 DITË SHËRBIM”

Myftinia e Tiranës zhvilloi më datë 19.12.2021, në ambientet e “Tirana International Hotel” aktivitetin kulturoro-fetar, me titull: “Myftinia Tiranë në 365 ditë shërbim”.

Këtë aktivitet e përshëndeti edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, i cili pasi përshëndeti të pranishmit për pjesëmarrjen e konsiderueshme, shprehu vlerësim të lartë për punën e kësaj myftinie në shërbim të përhapjes së mesazhit të Islamit në qytetin e Tiranës.

Ky aktivitet mblodhi së bashku qindra besimtarë të kryeqytetit, imamë të xhamive të ndryshme, përfaqësues shoqatash dhe institucionesh.

Myftiu i Tiranës, z. Lauren Luli, bëri një rezymë të arritjeve të myftinisë përgjatë gjithë vitit që lamë pas, duke falenderuar gjithashtu stafin e myftinisë, imamët, myezinët, partnerët e bashkëpunëtorët si dhe të gjithë ata që kanë punuar fort në realizimin e objektivave institucionale.

“Duke e kuptuar qartë detyrën dhe përgjegjësitë që ka myftinia jonë, bashkë me stafin dhe imamët, jemi munduar t’u japim hakun punëve në këto 365 ditëve kalendarike. Gjithçka bëhet, bëhet për të përçar paqësisht, pastër dhe drejt mesazhin e fesë tonë, Islamit” – theksoi Myftiu Luli gjatë fjalës së tij.

Në këtë aktivitet u vlerësuan me çertifikata mirënjohje edhe disa imamë të cilët kanë shërbyer me vite nëpër xhami të ndryshme të kryeqytetit.



PËRSE MUSLIMANËT DUHET TË JENË VËLLEZËR?

*"Uniteti i besimit bën gjithashtu të domosdoshëm
unitetin e zemrave dhe njësia e besimit
kërkon njësinë e shoqërisë sonë"*
– Said Nursi

Njerëzit ballafaqohen me një jetë që shpesh besojnë se e kuptojnë mjaft mirë. Disa veprojnë me bindje për ato që bëjnë, disa të tjerë kalojnë kohë për të reflektuar për ato që dinë dhe bëjnë. Kështu njerëzit ose kanë ose janë në kërkim të një perspektive se si të orientojnë jetën e tyre. Ata kërkojnë standarde reale për veprimet e tyre, sepse vetëm kështu do të mund të ishin të qetë për rezultatet që do të merrnin. Islami, është një rrugë që ofron të gjitha parimet me një integritet të plotë për një moral të gjithëanshëm, pra për një botëkuptim. Brenda këtij botëkuptimi islam, nuk përjashtohet as elementi i unitetit njerëzor. Ata që ndjekin këto parime islame quhen besimtarë, pra mu'min. Këta besimtarë kanë zgjedhur një rrugë, me të gjitha mjetet e nevojshme për t'i qëndruar asaj me besnikëri dhe për të arritur realizimin e jetesës individuale me një qëllim të vërtetë. Këto vlera, në parim janë një, për të gjithë besimtarët, pa asnjë dallim. Por realizimi dhe jetësimi i tyre nuk është dhe aq i thjeshtë. Prandaj ka hapësirë për ndarje, keqkuptim, urrejtje edhe mes vetë atyre që ndjekin këtë rrugë. Por Kur'ani sjell një kriter për të gjitha ata që kanë zgjedhur Islamin si rrugën e tyre:

"Me të vërtetë, muslimanët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj dhe druajuni Zotit, që të mëshiroheni". (Kuran, 49:10)

Si mund të kuptohet kjo lloj vëllazërie? Ne të gjithë e kuptojmë se, të kesh apo edhe të ndjehesh me dikë si një vëlla është një gjendje që na bën të hapur, të qetë, bashkëpunues, që ecim me synime të përbashkëta, që ndihmojmë njëri-tjetrin në punë etj. Mungesa e vëllazërisë a nuk do ishte e kundërta e gjithë këtyre?! Kur ne luftojmë kundër njëri-tjetrit, kur ndërtojmë mure komunikimi, kur nuk brengosemi për jetesën e tjetrit, kur nuk ulemi për bashkëpunim, a nuk janë këto fytyra, mungesë vëllazërie? Atëherë si mund të kuptohen muslimanët në këtë perspektivë, kur ne i kemi të gjitha këto pamje jo të mira?! Si mund ta kuptojmë, dhe mbi të gjitha si mund të arrijmë ta realizojmë këtë kriter kuranor?

Dijetari i mirënjohur, Said Nursi, në një nga letrat e tij ka analizuar mjaft mirë domethënien e këtij ajeti, dhe arsyen përse Kur'ani bën thirrje në vëllazëri, dhe nga ana tjetër, sjell edhe shkaqet që muslimanët kanë kaluar dhe vazhdojnë të kalojnë në përçarje e urrejtje. Ai shkruan se ne muslimanët jemi bashkuar në kuptimin që ne synojmë një të vërtetë, rrugën e Allahut. Të jetuarit me parimet e Tij duke i manifestuar me një mënyrë jetese e cila bazohet po në rrugën e Tij. Ja pse ai shikon një

domosdoshmëri uniteti mes besimtareve pasi që aty ku ka një unitet besimi duhet të ketë në mënyrë të pashmangshme edhe unitet zemrash, gjë që do të duhej të na çonte më pas në unitetin e shoqërisë.

Zemra (kalb) sipas traditës islame konsiderohet mjeti me anë të të cilit shquhen të vërtetat në gjendjen e tyre më reale. Islami para se gjithash është një e Vërtetë Absolute për muslimanët, dhe kjo e vërtetë manifestohet në zemrat tona. Ja pse edhe Said Nursi flet për një unitet zemrash. Muhamed Asad po ashtu ka një interpretim që meriton vëmendje sa i përket këtij ajeti. Ai në përkthimin dhe komentimin e tij të Kur'anit, konceptin e vëllazërisë e interpreton si një koncept që ka të bëjë me një unifikim mes muslimanëve në aspektin ideor. Duke qenë se Islami na paraqitet si një botëkuptim që integron çdo pjesë të jetës, si të kësaj bote dhe të botës tjetër, atëherë muslimanët duhet të unifikohen në këto parime në mënyrë që se bashku të arrijnë ta realizojnë mesazhin që përcjell kjo fe. Pasi që ky mesazh është tejet gjithëpërfshirës, nuk është e thjeshtë që një individ, apo edhe një pjesë e vogël ta përcjellë këtë. Pra, në rast se kemi një numër njerëzish që e kanë pranuar islamin, kjo përgjegjësi nuk është e vetëm disa vetave, por e të gjithë atyre burrave e grave që kanë pranuar të frymojnë sipas frymës së këtij mesazhi. Nëse ndodh që të ketë mosmarrëveshje mes muslimanëve, atëherë ato mund të jenë vetëm të arsyeshme në emër të së vërtetës dhe drejtësisë, siç ka shkruar Said Nursi. Kjo sepse, mosmarrëveshjet kanë të bëjnë me mjetet dhe jo me qëllimet finale. Madje këto mosmarrëveshje do të bënin që drejtësia dhe e vërteta të hetohen nëpërmjet shumë aspekte, gjë që edhe do ta pasuronte botën tonë ideore.

Sot për sot Islami ka shumë nevojë të paraqitet fillimisht me tërë botën e vet, ta shprehë realitetin që tregon për ekzistencën. Kjo detyrë varet nga ne që kemi zgjedhur këtë rrugë. Bota të cilën na shpalos Kur'ani është një botë magjepsëse, pasi që format, ngjyrat, idetë, gjeografitë, gjuhët, kozmosi në tërësi, metakozmosi, janë të gjitha pjesë e këtij realiteti. Njerëzit janë lexues dhe hetues të këtij realiteti. Muslimani merr çdo pjesë në leximin e këtij realiteti, ashtu siç lexon çdo ajet të vetë Kur'anit. Ne duhet të mbetemi vëllezër, pasi që vetëm kështu mund ta kuptojmë realitetin e Kur'anit dhe vetëm kështu mund ta shijojmë bukurinë e botës që na rrethon. Në botë do ketë pak më shumë drejtësi dhe më shumë kuptim për të jetuar nëse ne bashkohemi dhe ndahemi vetëm për hir të këtij mesazhi.

1. Said Nursi, Letrat, Sözlür, Istanbul, 2010, fq. 391-405.

2. Said Nursi, po aty, fq. 394.

3. Muhammad Asad, The Message of the Qur'an, The Book Foundation, 2003, fq. 1078-79.

4. Said, Nursi, po aty, fq. 402.

An aerial photograph of a dry, layered landscape with a turquoise lake. The terrain is brown and rocky, with distinct horizontal layers of rock. The lake is a vibrant turquoise color, contrasting sharply with the dry land. The sky is a pale, hazy blue.

Lut PROFETI *a.s*

Zoti, thotë në Kur'an se nuk ndëshkojmë askënd pa i dërguar më parë profetë që t'i ftojnë dhe t'i tregojnë besimin e drejtë. Për këtë arsye, ka patur shumë raste që në të njëjtën kohë të ketë dërguar disa profetë, madje edhe në vende të njëjta. Një ndër ata ishte edhe profeti Lut a.s, i cili jetoi në kohën e Ibrahimit a.s, dhe ishte ndër personat e pakët që i besuan profetësisë së tij pa ditur që më vonë Zoti do ta bënte profet edhe vetë atë.

Ai u dërgua profet tek populli i Sodomit i cili ndodhej buzë detit në Palestinë. Ata ishin njerëzit e parë më të shthurur që kishte parë njerëzimi deri asokohe. Të gjitha llojet e gjynaheve që Zoti kishte ndaluar, mbizotëronin në sjelljet e tyre. Më e theksuara ishte se, për herë të parë, njerëzimi kishte filluar imoralitetin në të njëjtën gjini.

Thotë Zoti në Kuran: "Përkujto kur popullit të vet Luti i tha: "A punoni të shëmtuarën, që asnjë nga popujt e botës nuk e bëri para jush. Vërtet, të shtyrë nga epshet, ju afroheni burrave duke i lënë gratë. Padyshim që ju jeni popull i shfrenuar" (Araf 80-81)

Teksa flasim dhe dëgjojmë rreth këtyre dukurive në historinë e njerëzimit, patjetër që mendja na shkon në kohët e sotme moderne, në të cilën shikojmë fenomene të ngjashme. Dhe është për të ardhur keq, pasi shohim se sjelljet e hershme të popullit të Lutit a.s janë shumë të ngjashme me të tashmen. Sjellje kjo e cila bie ndesh me natyrën e pastër njerëzore. Prandaj, nuk na ngel gjë tjetër vetëm se të distancohemi nga fenomene të tilla ashtu siç bëri dhe ky profet i Zotit.

I gjendur para një situatë të tillë, profeti Lut a.s ishte i pari profet që filloi të ftonte popullin e tij, të largoheshin nga kto veprime kaq të shëmtuara. Sepse e dinte shumë mirë se veprime të tilla binin ndesh me besimin në Zot.

Përgjigjen e tyre ndaj ftesës së Lutit a.s, Zoti e përmend kështu në Kur'an: "Dëboni ata (Lutin dhe besimtarët) nga vendbanimi juaj, sepse ata janë njerëz që ruhen shumë dhe rrinë të pastër" (Araf 82) Pra, sipas tyre, faji i Lutit a.s ishte se rrinte i pastër.

Nëse të qëndrosh i pastër moralisht e në të gjitha sjelljet, është faj, atëherë

miq le të jetë ky dhe faji ynë sot. Të distancohemi nga papastërti të tilla morale dhe të qëndrojmë me natyrë të pastër njerëzore ashtu si dërguari i Zotit, Luti a.s.

Le të na shikojnë me syrin e të prapambeturit për faktin se falemi 5 herë në ditë dhe jemi të pastër në moral. Kjo nuk duhet të na irritojë, ashtu siç Luti a.s e dinte se ishte me të drejtën e Zotit, ndonëse po e dëbonin nga qyteti vetëm se ishte i pastër. Pas gjithë përpjekjeve të shumta të Lutit a.s, njerëzit nuk hoqën dorë nga veprimet e tyre. Gjë që solli dënimin masiv nga ana e Krijuesit Fuqiptotë.

Zoti dërgoi engjëj me pamje njerëzish, djelmosha të rinj të cilët fillimisht ishin takuar me mikun e Allahut, Ibrahimit a.s. Kur ata erdhën dhe i kërkuan profetin Lut që ti pranonte si mysafir, Luti a.s u frikësua dhe u mërzi nga çmund të ndodhte pasi populli ta merte vesh që në shtëpinë e tij ndodheshin disa djem të rinj.

Mendohet se gruaja e tij informon popullin dhe të gjithë mblidhen para shtëpisë së Lutit ku dhe i kërkojnë atij ti dorëzoi mysafirët. Ndërsa ai i thotë se: "Kijeni frikë Zotin e mos më turpëroni me mysafirët e mi. a nuk ka ndër jush ndonjë njeri të mençur?" (Hud 78)

Por fjalët e tij nuk përbënin ndonjë rëndësi për ata. Si pasojë Zoti dërgoi ndëshkimin e madh. Ai thotë: "Kur erdhi urdhëri ynë, ne i përmbysur të gjithë duke i ngritur nga lart poshtë dhe mbi ta lëshuam gurë të fortë pa pushim" (Hud 82)

Sipas dijetarëve, ai popull u dënua në zonën ku ndodhet deti i zi në Jeruzalem. Zonë të cilën Zoti e ka lënë të vdekur që nga ajo kohë. Ai thotë: "Dhe ne e lam atë zonë si shenjë, argument. A ka ndonjë që merr shembull?" (Kamer 15)

Të nderuar miq!

Njeriu më i keq nuk është ai që bën gjynahe, por ai që i bën ato haptazi, pa u turpëruar.

"Turpi dhe besimi shkojnë gjithmonë bashkë, nëse hiqet njëri do të hiqet dhe tjetri, turpi është pjesë e besimit" thotë i dashuri i zemrave tona, Muhamedi a.s.

Zoti na ruajt nga çdo ves i pisët dhe i turpshëm. Amin.



*Dhuroji vetes një
fund të lumtur*

Jeta është si një bllok shënimesh. Dy faqe janë të plotësuar nga vetë Zoti. Në faqen e parë është datëlindja, ndërsa në faqen e fundit është data e vdekjes. Faqet e mesit janë bosh. Ato i janë lënë njeriut që ai t'i mbushë ashtu siç ai dëshiron. Është shumë e habitshme dhe rast për të reflektuar hapësira e lirisë që Allahu i ka dhënë njeriut në jetë. Njeriu është lënë i lirë të veprojë, pa qenë i detyruar nga Ai që Vetë e krijoi dhe po të donte, mund ta kufizonte krijesën e vet. Megjithë këtë, secili prej nesh kur rritet, dëgjon dhe gjen të gatshme, udhëzime hyjnore se si Allahu dëshiron që ne ta jetojmë jetën e kësaj bote. Gjithashtu, Ai na ka sqaruar edhe pasojat me të cilat do të përballemi, nëse do jemi prej atyre që i shkëlpin urdhrat e Tij, si dhe shpërblimet që na presin, nëse do i bindemi dhe do i zbatojmë porositë e Tij, qoftë ato të shpallura në Kuranin Fisnik, apo ato që janë përcjellë nëpërmjet gojës së profetit Muhamed apo veprimeve të tij.

Pas çdo viti që kalon, apo në fillimin e çdo viti të jetës sonë, kur kthejmë kokën pas, ndodh që të ndihemi të pakënaqur me veten tonë në këtë drejtim. Ndoshta e gjejmë veten mosrespektues ndaj shumë rregullave të vendosura nga i Madhi Zot; ndoshta shumë prej tyre i kemi thyer duke qenë edhe të vetëdijshëm. E shohim veten me keqardhje dhe të dobët karshi mëkateve në të cilat kemi rënë jo pak herë. Reflektimi me veten është një akt shumë i rëndësishëm për këdo që synon qëllime sublime; për këdo që ia njeh dobësitë vetes dhe përpiqet për të gjetur forcë dhe vullnet për ta përmirësuar veten. Ne nuk e kemi mundësinë për të ndryshuar të kaluarën, por kemi në dorë të ardhmen tonë dhe fundin tonë.

Le të sjellim një shembull ilustrues: Është për të ardhur keq se si disa njerëz bëjnë të pamundurën e tyre për të qenë korrektë ndaj urdhrave dhe porosive të shefave dhe drejtorëve të tyre, dhe nuk e shprehin të njëjtën gatishmëri ndaj urdhrave të të Madhit Zot. Shefi të jep vetëm rrogën, ndërsa Zoti të ka dhënë jetën, shëndetin, familjen, mirësi e begati pa fund. Është për të ardhur keq se si disa njerëz çfarë nuk bëjnë, si e si t'u hyjnë në sy të tjerëve, apo që t'u pëlqejnë të tjerëve. Sa mirë do ishte të bënin të njëjtën gjë për të arritur kënaqësinë e Allahut të Lartësuar. Për të arritur pikërisht këtë, Allahu na ka dhënë një jetë të tërë, por njeriu prapë se prapë tregohet neglizhent ndaj Zotit dhe nuk tregohet i tillë ndaj njerëzve.

Secili prej nesh është shkrimtar i bllokut të jetës së vet. Secili prej nesh ka dy shkruar, puna e të cilëve është të regjistrojnë çdo fjalë dhe veprim që

ne bëjmë. Imagjino se sa të rëndësishëm jemi tek Zoti, saqë në shërbim të çdo njeriu, janë vënë dy engjëj regjistruar të veprave tyre, qofshin ato të mira apo të këqija. E gjithë kjo, që asnjëri prej nesh të mos ketë asnjë pikë justifikimi Ditën e Gjykimit, ditën kur secilit prej nesh i vjen libri i vet me gjithçka që ka punuar e folur në jetën e kësaj bote. Nëse do i lexoje faqet e kaluara të jetës tënde, a do kishe guxim t'i publikoje në rrjetet sociale si në facebook apo instagram? Një njeri normal nuk do donte që të metat e tij dhe veprimet e pahijshme t'i zbuloheshin dhe njerëzit t'i komentonin sepse kështu do të ndihej i turpëruar dhe i përlur ndaj tyre. Fakti që Allahu t'i ka mbuluar të metat dhe paturpësitë që mund të kesh bërë në të kaluarën, do të thotë që Ai dëshiron që ti të dukesh njeri i bukur dhe i mirë para njerëzve. Ashtu siç mundohesh të shfaqësh anën tënde më të mirë para njerëzve, preokupohu që të shfaqesh i tillë edhe ditën kur gjithçka do të vihet në peshore dhe kur askujt nuk do t'i hyhet në hak për asgjë të vogël e të madhe që ka vepruar në çdo ditë dhe natë të kësaj bote kalimtare.

Asnjëri prej nesh nuk ka ardhur në këtë botë rastësisht. Ka qenë caktimi, dëshira dhe vullneti i Krijuesit të universit që ne të jemi banorë të kësaj toke, në mënyrë që kjo tokë të dëshmojë për çdo lëvizje tonën. Ajo do dëshmojë për çdo hap drejt xhamisë, për çdo hap drejt bamirësisë, drejt punëve të mira. Gjithashtu ajo është dëshmitare për çdo hap drejt haramit, drejt veseve të ulëta dhe të turpshme. Ki kujdes ku shkel sepse hallalli është i qartë ashtu siç është i qartë edhe harami. Ti, unë dhe çdo qenie njerëzore janë të ftuarit e Allahut në këtë botë, prandaj të sillemi si të tillë, pasi nuk kemi për të qëndruar gjatë, ashtu siç mysafiri nuk qëndron gjatë atje ku shkon për vizitë apo ku është i ftuar. Sillet i matur dhe i kujdesshëm që të lërë përshtypje pozitive pas largimit të tij. Le të veprojmë kështu dhe ne, sepse vizita dhe qëndrimi ynë në këtë botë frymore nuk dihet sa zgjat dhe befasisht mund të rrëzohemi nga avioni i kësaj bote dhe nëse nuk jemi pajisur me parashutë të fortë, atëherë fundi ynë dihet se cili do të jetë. Kështu edhe fati ynë në botën e përtejme, nëse nuk do të kemi punë të mira që të na shoqërojnë në rrugëtimin e përjetshëm, do të jemi pjesë e një torture pa mbarim, gjë të cilën vetëm kur e mendon të tmerron, jo më ta imagjinosh veten pjesë të atyre dënimeve të dhimbshme për mëkatarët. Prandaj i dashur vëlla dhe motër, pendohu urgjentisht dhe jeto me nijete të qarta për të fituar kënaqësinë e Allahut, që Ai të të dhurojë lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Amin.

Drita Islame

**NJË SHKËNDI E DRITËS SË FESË ISLAME
NË SHQIPËRINË PASKOMUNISTE**



Në vitet '90-ta në botë, sidomos në Bashkimin Sovjetik dhe në Ballkan, u përjetuan ndryshime të mëdha politike, të cilat ndikuan edhe në fillimin e ndryshimeve në aspekte të tjera në shoqëri. Kjo periudhë për shumë popuj shpreh edhe procesin kalimtar nga një sistem në tjetrin. Ndërsa, në anën tjetër, shpreh kalimin nga një botëkuptim lokal e nacional në atë global, pra, nga një sistem komunist, gjegjësisht sistem monist, në një sistem demokratik. Demokracia, në krahasim me komunizmin, është një sistem shumë më i përshtatshëm për jetën fetare. Me një fjalë në sistemin demokratik u përjetua një rikthim fesë dhe aktiviteteve fetare në përgjithësi. Kurse në aspektin global, kjo është një kohë kur më veç bëhen hapat e para në kalimin prej kohës moderne në atë postmoderne. Prej një kohe kur feja mohohej krejtësisht, në një kohë kur feja luan një rol shumë të rëndësishëm për njeriun dhe për shoqërinë në përgjithësi. Këtë kohë postmoderne e karakterizon edhe një dukuri shumë e rëndësishme që është globalizmi, i cili pretendon dy fakte shumë me rëndësi. E para, globalizmi pretendon që edhe politikisht, edhe ekonomikisht, edhe në aspektin social të dominojë ndikueshëm në tërë botën. Kurse e dyta, globalizmi pretendon të shtojë ndikimin, varësinë dhe lidhjen reciproke në dhe mes shteteve dhe shoqërive në tërë botën. Varësia reciproke, e cila ritet bashkë me globalizmin, vazhdon kontinuitativisht që jetën e çdo njeri ta bëjë edhe më të varur ndaj vendimeve dhe lajmeve që vijnë aq larg sa që njeriu nuk ka mundësi që në një mënyrë tjetër t'i posedojë ato pranë vetes.

Madje, në fillim të shekullit XXI, edhe shtetet më të përparuara dhe më të fuqishme kanë qenë të detyruara të ballafaqohen me nevojën e varësisë reciproke. Shtetet nacionale, që në bazë janë shtete me kufij të caktuar, janë të detyruara të ballafaqohen me ndikimin pa kufij të teknologjisë së komunikimit, të qarkullimit të banorëve, të acarimeve dhe të konflikteve rajonale, shoqatave/organizatave multinacionale dhe të problemeve të tjera ekonomike.

Kështu që, në Shqipëri një rikthim dhe një rizgjim i këtyre filloj me shkatërrimin e regjimit komunist të Enver Hoxhës. Kështu ato pak xhami dhe

kisha që kishin mbijetuar në atë sistem barbar u kthyen përsëri jetës, gjallërisë dhe aktiviteteve fetare, ashtu si edhe ato pak klerikë fetarë që kishin mundur të mbijetonin në atë periudhë të vështirë, iu kthyen përsëri obligimit të tyre fetar, nëpër xhamia dhe nëpër kisha (qofshin ato kisha ortodokse ose kisha katolike). Përsëri filluan të dalin në dritë librat, broshurat, fletushkat, revistat, gazetatat dhe shkrimet tjera fetare, të cilat gjatë sistemit monist ishin të burgosura nëpër arkiva, biblioteka shtetërore apo private. Sidomos, në fillim u punua në restaurimin dhe në ndërtimin e tempujve të ri. U hapën edhe shkolla të mesme dhe fakultete (akademi) fetare. Kështu që jeta fetare filloi që në çdo aspekt të riorganizohet dhe zhvillohet. Këtij zhvillimi i ndihmuan jo vetëm populli fetar i Shqipërisë, ndihmën e tyre u munduan që ta japin edhe fetarët, pa marrë parasysh se cilës fe i takonin, e shteteve ku feja më parë ka qenë e lejuar për veprim. Prej ndihmave që vinin në Shqipëri, krahas atyre që ishin pastër me qëllim fetar, kishte edhe të atilla që kishin prapavijë politike dhe kulturë asimiluese. Pra, pas lëkundjeve të themeleve të totalitarizmit në përgjithësi në Ballkan, madje shembjes së tërësishme në Shqipëri, edhe organet periodike, këtu mund të përmendim edhe revistën Drita Islame, jepnin shpresë se po ringjallet jeta fetare dhe se me demokratizimin e jetës politike do të përmirësohet edhe jeta fetare në përgjithësi, e ajo islame në veçanti.

Ballkani është një botë në vete. Ai nuk mund të mendohet pa disa gjuhë, disa fe/religjione, disa kultura etj. Dhe të gjitha këto kanë luajtur rolin e tyre në këtë vend, në krijimin e identitetit të këtij vendi, qoftë pozitiv apo negativ. Pa një islam, krishterizëm, gjegjësisht katolicizëm e ortodoksizëm, pa hebraizëm e pa paganizëm dhe dualizëm (Maniheizëm), pa ateizëm definimi i Ballkanit do të ishte i mangët. Me një fjalë, ky vend gjeografik gati se i ka përjetuar të gjitha llojet e sistemeve politike e administrative, kurse ky sistem ateist i llojit të veçantë që ka qenë në Shqipëri është i pakrahasueshëm. Kështu që, pas rrënimit të këtij regjimi totalitar fillojnë të rilindin vlerat kombëtare e fetare që kanë qenë të ndaluara gati një çerek shekulli. Në këtë periudhë rilind edhe



periodiku islam i titulluar "Drita Islame", për të cilën mendoj se kuptimisht është vazhdimësi e periodikëve që botoheshin në botën shqiptare para ndalimit të fesë si "Zani i Naltë", "Kultura Islame", "Njeriu", etj.

Drita Islame ka një barrë të rëndë që të edukojë brezin e ri me fenë, e cila sa ka potencial të ndikojë pozitivisht, ajo ka po aq potencial të ndikojë edhe negativisht. Ajo, sa mund ti bëjë mirë njeriut, po aq mund ti bëjë edhe keq atij. Ajo, sa mund të krijojë paqe në një vend, mund të jetë shkak edhe për luftë. Luftërat në Ballkan midis serbëve e boshnjakëve, midis serbëve e shqiptarëve, midis shqiptarëve dhe maqedonëve, midis serbëve e kroatëve, midis grekëve e shqiptarëve, sa mund të jenë me përmasa nacionale, po aq janë edhe me përmasa fetare, qoftë të jetë ajo në mënyrë direkte ose indirekte, si motivuese e luftës, apo si mbështetëse e saj. E gjithë kjo, për mendimin tim, varet nga mënyra e përdorimit të fesë, mënyra e trajtimit të saj. Pra, ai që e beson dhe e praktikon fenë varet se si e përdor atë. Kurse ai që duhet të jep një vendim ose të marr një qëndrim ndaj fesë, varet se në çfarë rethanash dhe me çfarë bindje e ka bërë atë ose, se sa serioz është ai në qëndrimin e tij. Pandaj për mendimin tim, periodiku Drita Islame ka luajtur rol shumë të rëndësishëm në prezentimin dhe në interpretimin e drejtë të fesë Islame, e cila është kundër dhunës, vrasjes, keqpërdorimit të fesë, keqtrajtimit të tjetrit etj.

Pikërisht për këtë, feja është një koncept që zhvillohet brenda kornizave të shpalljes hyjnore dhe përcjelljes profetike. Tradita konstituive e Islamit, e njëkohësisht edhe e feve të tjera qiellore, e quan fenë dhuratë të jashtëzakonshme hyjnore, dobiprurëse dhe liridhënëse. Feja është sistem hyjnor, i cili njerëzve të arsyeshëm u mundëson t'i kahëzojnë ndjenjat e tyre dhe të bëjnë vepra të mira. Duke e përfaqësuar themelin e jetës kuptimore të njeriut dhe shoqërisë, feja është tejet funksionale në aspektet sociale dhe psikologjike të jetës. Pikërisht për këtë edhe paraqet një dukuri e cila nuk mund të lihet pas dore. Historia, në çdo epokë, flet për marrëdhëniet e ngushta mes fesë, njeriut dhe shoqërisë. Dukuria e fesë ka ekzistuar në çdo shoqëri njerëzore dhe ka ndikuar dukshëm në formimin dhe ndryshimin e sistemeve mendore dhe shoqërore. Pikërisht për këtë edhe u tregua si i pabazë dhe joreal pohimi se me zhvillimin e shkencave pozitive do të mënjanohet nevoja për fetë tradicionale dhe se njerëzit do ta marginalizojnë idenë fetare. Një situatë e ngjashme është duke

u përjetuar edhe me globalizimin dhe sfidat që njerëzimi është duke i përjetuar me të.

Kështu që, "Drita Islame", edhe pse në fillim përbëhej prej disa faqeve dhe disa shkrimeve, ajo simbolikisht përfaqësonte zërin e fesë. Duke u nisur nga kjo, mund të themi se:

- "Drita islame" e viteve '92-ta të shekullit të kaluar ka qenë zëri i parë zyrtar i shkruar për shqiptarët muslimanë të Shqipërisë, pas shkatërrimit të sistemit totalitar komunist;

- Ajo u ka dhënë mundësi njerëzve të edukuar fetarisht më herët, të cilët kanë arritur të mbijetojnë në sistemin komunist, që ti shprehin mendimet e tyre fetare lirshëm dhe të njëjtat t'ua kumtojnë të tjerëve;

- Ajo e ka mbrojtur dimensionin sunit dhe hanefit fetar të fesë islame, dimension ky që në Shqipërinë parakomuniste ka qenë dominant;

- Ajo ka qenë diga e parë që shqiptarët i ka mbrojtur nga ndikimet e fraksioneve të ndryshme të botës islame.

Sot, si gjithmonë, janë tre premisa bazë pa të cilat nuk mund të bashkëjtohet dhe nuk mund të formohet një shoqëri tolerante e të thuhet se jemi një vend pluralist. E para premisë është pranimi i tjetrit. Të pranohet kultura, besimi, tradita folklori i grupit tjetër etnik e religjioz, gjegjësisht të gjithë duhet të pajtohen me diversitetin kulturor, fetar e tradicional në vend. E dyta ka të bëjë me njohjen e tyre, pra nuk mund të bisedojmë vetëm për një pranim verbal dhe të thatë pa praktikë. Por pranimi duhet të pasohet nga njohja e asaj që i takon tjetrit. Kurse premisa e tretë, ka të bëjë me shpëtimin nga vetizolimi, gjegjësisht të jemi të hapur ndaj njëri tjetrit, çështje kjo të cilën e kërkon edhe procesi i globalizimit sot. Vetizolimi e bën njeriun, kulturën, fenë, grupin më të ashpër dhe më të rrezikshëm për veten dhe për të tjerët. E nëse e kemi parasysh se një njeri, një kulturë, një fe është e pamundur që të jetë i vetizoluar deri në fund, atëherë kuptohet se nëse vetë ai ose ajo nuk çlirohet nga ai vetizolim, më vonë kur do të kuptohet realiteti që deri në atë moment ka qenë i izoluar, do të del në shesh e vërteta, që në atë rast do të jetë edhe faqja e zezë e asaj apo atij.

Prandaj është e një rëndësie të veçantë që shteti dhe të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare, secili në formën e vet, të kontribuojë sinqerisht dhe realisht në këtë drejtim. Pra të mundësojë që njerëzit, kulturat, fetë etj., të pranojnë njëra tjetrën. Institucionet këtë mund ta bëjnë vetëm duke u dhënë atyre mundësi më të mëdha

që ata ta njohin njëra tjetrën më mirë dhe më për së afërmi, dhe në fund të shpëtojnë nga vetizolimi, i cili sjell vetëm mundësi të mbjellë urrejtje.

Për këtë, çdo udhëheqësi, qoftë shtetëror apo joqeveritar, në lidhje me periodikun në përgjithësi, e me "Dritën Islame", në veçanti, duhet patur parasysh me sa vijon:

1-Vetëdijësimin për periudhën postmoderne që na ndanë nga periudha moderne, kurse Ballkanin edhe nga periudha komuniste;

2-Duhet mbjellur ndjenjën e rëndësisë së fesë në riparimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore, dialogut, tolerancës etj;

3-Duhet dhënë shumë rëndësi njohjes së historisë, kulturës, fesë së vet, po edhe të historisë, kulturës e fesë së tjetrit, me të cilën jepet mundësia e njohjes së tjetrit, sa më tepër njohje aq edhe më tepër respekt reciprok.

4-Duhet zhdukur ndjenjën e urrejtjes ndaj njëri tjetrit, që është mbjellur gjatë historisë. Këtë duhet ta bëjnë institucionet shtetërore, bashkësitë fetare, shkollat fillore, shkollat e mesme si dhe universitetet. Ende, për fat të keq në Ballkan, për të cilën mendoj se është një sëmundje e trashëguar nga periudha komuniste, ka problem midis "intelektualëve fetarë" dhe "intelektualëve laikë", pa dallim kombësie dhe feje. As i pari nuk i pranon si duhet të dytët e as i dyti s'i pranon si duhet të parët. Ata as nuk dinë por as që duan të dinë sinqerisht për njëri tjetrin. Ende është gjallë ajo ndenja antitjetër në kombësi, kulturë, gjuhë dhe fe;

5-Për ta arritur këtë duhet shkruar dhe lexuar për njëri tjetrin si dhe duhet takuar sa më shumë njëri tjetrin, duke biseduar dhe qarë halle në këtë drejtim.

Këtu do të kisha përmendur mendimtarin dhe intelektualin e njohur gjerman, Hans Kung, i cili merret me çështjen e dialogut dhe të bashkëjetesës. Ai në thënien e tij të njohur: "Pa paqe ndërreligjioze, nuk ka paqe ndërnacionale; pa dialog ndërreligjioz, nuk ka paqe ndërreligjioze; pa njohjen dhe hulumtimin e themeleve fetare, nuk mund të ketë dialog ndërreligjioz", thekson se paqja ndërnacionale dhe ndërjetare janë të lidhura ngusht njëra me tjetrën. Por në fund potencon se ato varen prej një njohjeje reciproke të themeleve të njëra tjetrës.

Dua të përmend edhe dy gjëra me rëndësi që më kanë lënë përshtypje shumë të madhe nga një trajnim të realizuar në ShBA.

E para, ishte mosekzistimi i kompleksitetit tek njerëzit, madje edhe nëpër institucionet edhe më të mëdha dhe të nivelit më të lartë shkencor si universitete etj., se kanë të

bëjnë me një njeri që është tjetër etnitet, racë, religjion apo ndonjë bindjeje tjetër çfarëdo qoftë ajo.

Mendoj se ne që jetojmë, sidomos në Gadishullin Ballkanik, kemi më së tepërmi nevojë për ta zhdukur ndjenjën, edhe atë shumë të theksuar, të ekskomunikimit të tjetrit nga rrethet tona, pse nuk është sikur ne, nuk mendon sikur ne, nuk beson sikur ne, etj.

Kurse e dyta, ishte sistemi sekular i shtetit, i cili ishte shtet i ndarë nga kisha, por vetë shteti ishte "fetar", dhe askund nuk pashë ose të paktën nuk dëgjova për ndonjë vendim që ishte antifetar. Kryetari i shtetit sekular amerikan, bënë betimin në librin e shenjtë, kurse dollari amerikan përmban fjalë religjioze. E njëjta gjë shihet edhe në fjalët, bisedat, debatet parazgjedhore të kandidatëve për president të ShBA-ve. Kështu, do të pajtohesha me idenë e papës, Benedikti XVI, i cili në vizitën e tij në ShBA (prill-2008), ndër tjerash tha se, Evropa duhet të marrë për model sistemin sekular amerikan.

Në fund dua të theksoj se periodikët islamë, konkretisht "Drita Islame", duhet të mundësojë që të gjitha institucionet relevante në vend dhe më gjërë të kuptojnë peshën e fesë, pasi për fenë duhet të mendojnë të gjitha instancat shoqërore e shtetërore në vend. Këtu nuk mendoj se të gjithë duhet patjetër të besojnë. Besimi është çështje individuale. Por që ta shfrytëzojnë fenë pozitivisht, që ajo të jetë në shërbim të shoqërisë, ajo duhet trajtuar si shumë serioze, e jo si diçka me të cilën merren njerëzit e prapambetur, naivë, primitivë e të pashkolluar. Pasi ky lloj mendimi, sipas meje, është rezultat i një qasje shumë naive dhe injorante ndaj fesë.

Dhe si rezultat i kësaj, ajo mund të dalë prej kontrolli, jo pse feja është diçka e keqe, por sepse feja është diçka e madhe dhe nuk mund të mbahet e mbyllur. Shtetet në Ballkan, nuk duhet që fenë ta shfrytëzojnë për qëllimet e tyre politike, por ata duhet të investojnë në këtë drejtim në mënyrë të barabartë. Vetëm në këtë formë krijohet stabilitet në vend. Në të kundërtën komunitetet fetare edhe kur heshtin ndaj padrejtësisë shtetërore është rrezik e jo më të bëjnë ndonjë veprim të hapur në atë drejtim. Vetëm në këtë formë ka mundësi që të ruhet shoqëria nga paraqitja e grupeve radikale dhe shqetësuese për mesin tonë.

Urime "Drita Islame"!

Urime botuesve të saj!

Prof. dr. Qani Nesimi
Myfti i Tetovës



Motivimi TEK FËMIJËT

Shekulli në të cilin jetojmë është quajtur ndryshe si shekulli i informacionit të cilin mund ta arrijmë shumë lehtë dhe shpejt, thjesht me një klikim. Mënyra e përdorimit të informacionit ndan në nivele të ndryshme shoqëritë e sotme. Përdorimi i drejtë dhe i duhur i informacionit të marrë do të na sjellë një edukim cilësor dhe frytdhënës. Fëmijët e sotëm mund të quhen dhe fëmijë të teknologjisë por nuk duhet të harrojmë që tek fëmijët, pikë së pari duhet të ekzistojë dëshira për të mësuar e cila do të shoqërohet me mundësitë e shumta, me përdorimin e drejtë të tyre dhe me vlerësimin e njohurive të përfuara nga interneti. Fëmijët të cilët e shijojnë të mësuarin janë gjithmonë kuriozë për të zbuluar gjëra të reja dhe ndihen të motivuar e energjikë. Fëmijë të tillë do të ndjekin shkollën me dëshirë dhe do ta shfrytëzojnë atë sa më mirë për edukimin e tyre. Çfarë mund të bëjmë ne si prindër për të frymëzuar tek fëmijët dëshirën për të mësuar dhe si mund të nxisim motivimin?

Kjo dëshirë e cila vë në lëvizje njeriun në fushën e psikologjisë quhet motivim. Ndonjëherë kjo dëshirë mund të lindë brenda njeriut dhe quhet motivim i brendshëm ndërsa kur nxitet nga faktorë të jashtëm konsiderohet si motivim i jashtëm. Motivimi i jashtëm sigurisht që do të zhduket sapo të ikin nxitësit apo faktorët nxitës. E rëndësishme është që kjo ndjenjë të kultivohet gradualisht tek fëmija.

Nëse fëmija nuk paraqet asnjë lloj dëshire ndaj shkollës dhe procesit të të mësuarit atëherë ka ardhur koha të analizojmë edhe një here nevojat e fëmijës. Sepse ne thelbin e një dëshire qëndron nevoja apo kërkesa për të. Krahas nevojave fiziologjike si ngrënia, veshja, mbrojtja njeriu ka edhe nevoja emocionale si vlerësimi, lavdërimi, dashuria, përkatësia etj. Ne mund t'i parashtrijmë shumë gjëra përpara fëmijës tonë por asnjëra prej tyre nuk do të ketë vlerë nëse nuk dimë kërkesën e tij. Në shumicën e rasteve prindërit përpiqen të plotësojnë çdo kërkesë e cila ka lidhje me nevojat fizike të fëmijës por harrojnë apo nënvlerësojnë ato emocionale. Nuk vihet në dyshim dashuria e prindërve por e rëndësishme është që kjo dashuri të ndihet nga fëmijët. Ndonjëherë prindërit e barazojnë dashurinë e tyre me notat e marra në një test apo provim shkolle. Por një dashuri e kushtëzuar është toksike dhe çënon marrëdhënien prind fëmijë. Fëmijët kërkojnë të pranohen dhe të duhen pavarësisht rezultateve akademike. Nëse ai ndihet i vlerësuar kjo do ta bëjë atë më të pavarur, me vetëbesim e siguri .

Sjellja dhe qëndrimi i mbajtur ndaj fëmijëve tanë ose fjalët e përdorura më shpesh do të strukturojnë konceptin e tyre individual. Kritikata e vazhdueshme do të ndikojnë negativisht në pengesën e marrjes

së iniciativave të reja. Si prindër na takon t'i nxisim me një gjuhë e cila pranon kapacitetin e tyre në mënyrë që t'u rritet vetëbesimi.

Pritshmëritë e prindërve mbi nivelin e suksesit akademik të fëmijëve mund të bëhen shkak për krijimin e ndjesisë së pamjaftueshmërisë tek to duke i krijuar në kokë mendime si: 'unë nuk mund të arrij pritshmëritë e prindërve, nuk mund t'ja dal'. Nëse vazhdohet kështu, fëmija do të zgjedhë të bëjë indiferentin dhe nuk do të përpiqet aspak të ndryshojë situatën. Në këtë pikë kërkohet një bashkëpunim i mirëfilltë me shkollën dhe mësuesit për të njohur më mirë fëmijën . E rëndësishme është njohja e çdo sukcesi të fëmijës qoftë e edhe i vogël dhe vlerësimi me nota pozitive. Nëse ne nuk vlerësojmë përpjekjet e fëmijës dhe fokusohemi vazhdimisht tek nota 10 atëherë ky qëndrim do të thyejë motivimin e tij.

Një gabim tjetër i prindërve është dhe krahasimi i dëftesës së fëmijës me dëftesën apo arritjet e fëmijëve të tjerë si të vëllait, të motrës, të kushërinjve apo shokëve të klasës. Ose mund ta krahasojë atë me arritjet e veta si prind. Krahasimi është e keqja më e madhe që mund t'i bëhet dikujt sepse e demoralizon totalisht palën përballë.

Fëmijës i duhen dhënë përgjegjësi në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e tij në mënyrë që të provojë aftësitë e tij. Ndjenja e përgjegjësisë i duhet dhënë që në periudhën parashkollore sepse një fëmijë i përgjegjshëm do të përpiqet të bëjë detyrat, të mësojë dhe të zbatojë të gjitha kërkesat e dhëna nga shkolla e mësuesi si pjesë e përgjegjësisë së tij.

Në qoftë se duam të nxisim motivimin e brendshëm të fëmijëve dhe duam që ata të jenë të vendosur duhet t'i përfshijmë në procesin e vendimmarrjes duke i shpjeguar edhe arsyet e vendimit.

Ne do të mundësojmë fokusimin e fëmijës tek një qëllim i caktuar duke e ushqyer shpirtin e tij me një gjë e cila e bën të ndihet mirë. Mund të krijojmë një plan të përcaktuar me anë të të cilit ndihmojmë fëmijën në plotësimin e qëllimeve afatshkurta, në zbatimin e detyrave të dhëna dhe në ndërmarrjen e hapave të vegjël. Kjo mënyrë do të ndihmojë fëmijën të jetë i qartë në mendime dhe qëllimet e vendosura dhe do të zhdukë dyshimin dhe pavendosmërinë.

Gjurmët e një historie sukcesi lidhen ngushtë me përkushtimin e njeriut ndaj qëllimit të caktuar dhe me dëshirën e fortë që ai ka për ta arritur këtë qëllim. Bërja e punës me pasion e dashuri do të sjellë një burim të pashtershëm energjie dhe produktivitet maksimal.

Me shpresën e edukimit dhe rritjes së fëmijëve të motivuar , të vendosur e të përkushtuar në arritjen e qëllimeve të vendosura...

Misvaiku

ILAÇ PREVENTIV PËR DHËMBËT





Njëra prej mënyrave më efikase për mbrojtjen e dhëmbëve është misvaku i cili është përmendur disa herë në hadithet e Pejgamberit s.a.v.s..

Misvaku është shkop i cili përdoret për masazhin e brendisë së gojës dhe ka marrë emrin nga fjala arabe "judlik", që bukvalisht mund të përkthehet në kuptimin "masazh" (që d.m.th. masazhi i brendisë së gojës).

Lloji më i mirë i misvakut është druri "arak" (Salvadora persica). Misvaku i Pejgamberit s.a.v.s. ka qenë nga ky dru. Misvaku është degëz e forcuar me minerale natyrore që ndihmojnë në pastrimin e dhëmbëve, pastaj me inkubatorë tjerë të cilët pengojnë gjakderdhjen nga mishi i dhëmbëve, materie që mbysin mikrobet (baktericid) me aromë natyrale të freskët.

Misvaku është brushë ideale, natyrale e cila përmban më shumë përbërës kimik se çdo pastë tjetër artificiale për dhëmbë.

Sikur brusha për dhëmbë, misvaku pastron në mes dhëmbëve dhe nuk thehet nën asnjë presion, bile është më i fortë dhe fleksibil. Palca e misvakut formësohet në formë të përshtatshme duke pastruar bile edhe ushqimin e mbetur në mes dhëmbëve, njëkohësisht duke mos e dëmtuar mishin e dhëmbëve.

Pejgamberi s.a.v.s. para 14 shekujve na ka mësuar ta përdorim misvakun për t'i pastruar dhëmbët dhe gojës duke i dhënë aromë të këndshme.

Enesi r.a. transmeton që Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Sa herë që Xhibrili më vizitonte më këshillonte të shërbehem me misvak."

Ngecjet e ushqimit në mes dhëmbëve ofrojnë mjedis ideal për zhvillimin e miliona baktereve që mund të shkaktojnë sëmundje qelbuese të mishit të dhëmbëve dhe cistë. Në rastet më të rënda mund të vijë deri të

inflamimi i maksilës ose mandibulës.

Bakteret gjithashtu prodhojnë enzime të dëmshme që tretin kalciumin nga dhëmbët duke shkaktuar karies. Në raste serioze, bakteret krijojnë gazra që shkaktojnë kundërmim nga goja. Para pak kohësh studimet zbuluan që misvaku posedon minerale natyrore që mbysin mikrobet dhe mënjanojnë pllakëzat.

Pejgamberi s.a.v.s. e kishte zakon të fërkojë misvakun me gjuhën, dhëmbët dhe mishin e dhëmbëve.

Ebu Musa el-Esh'ariu r.a. ka thënë: "E kam vizituar Pejgamberin s.a.v.s. ndërsa misvakun e kishte në majën e gjuhës."

Përbërësit kimik të misvakut

Misvaku përbën 19 përbërës efikas veprues. Më të rëndësishmit në mesin e tyre janë:

1. Inkubitorët e acidit antibakterial. Këta janë materie natyrale dhe mund të përdoren për ndaljen e gjakderdhjes. Këta pastrojnë edhe plagën më të vogël ekzistuese në mishin e dhëmbëve. Gjatë përdorimit të parë misvaku mund të ketë shije të djegës, ngase në të është gjetur substanca e ngjashme me senfin, i cili lufton qelbosjet në sojë dhe shkatërron bakteret.

2. Minerale sikur natriumi, klori, kaliumi, bikarbonati i natriumit, dhe oksidi i kalciumit. Këta pastrojnë dhëmbët. P.sh. asociacioni dental Amerikan mendon se bikarbonati i natriumit është përbërës i dëshiruar i pastave të dhëmbëve.

3. Vajra aromatike natyrale që janë të shijshëm dhe kanë aromë të këndshme duke i dhënë edhe gojës aromë. Këta përbëjnë rreth 1% të misvakut.

4. Enzimet që pengojnë krijimin e pllakëzave që shkaktojnë sëmundjet e mishit të dhëmbëve. Pllakëzat janë shkas numër një i humbjes së hershme të dhëmbit.

5. Përbërësit që parapengojnë qelbosjen dhe bakteret, e që veprojnë si një lloj antibiotiku duke zvogëluar sasinë e baktereve në gojë.

Disa shkencëtarë kanë zbuluar se përdorimi i brushës së thatë shkakton dëmtimin e shpejtë të dhëmbëve, ndërsa brusha e lagësht zbut dëmtimin e dhëmbëve. Për këtë misvaku duhet lagur para përdorimit. Nëse nuk ka alternativë, mjafton pështyma për ta lagur drurin. Misvaku gjithashtu përmban kemikale që shtojnë sasinë e pështymës në gojë e cila ofron mbrojtje natyrale dhe pastrim.

Përktheu: Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi



YMER SARAÇI (1906-1975)

**KUJTIME TË NJË MËSUESI PËR MËSUESIN E TIJ
YMER SARAÇI, NGA DIPLOMIMI NË GRAC, TE BURGJET KOMUNISTE**

Hafiz Ali Podgorica lindi në vitin 1855 në Podgoricë në një familje patriotësh shqiptarë. Prindërit e tij Abdullah dhe nëna Pashja e lanë jetim Aliun në moshën 6 vjeçare.

Atë e tërhoqën xhaxhallarët e tij, që banonin në Shkodër, ku kreu filloren dhe gjimnazin osman. Ai mësoi edhe Kur'anin përmendësh, duke marrë titullin Hafiz. Më vonë shkoi në Stamboll, ku u njoh me patriotët e atjeshëm. Ishte shok i Ismail Qemalit, Jani Vretos, Koto Hoxhit e shumë të tjerëve. Bashkë me ta u pajis me ndjenjat dhe idetë kombëtare për lirinë e Shqipërisë dhe përhapjen e mësimt të gjuhës shqipe.

Mbasi u kthye në Shkodër punoi si avokat e ndihmës gjyqtar. Bashkëpunoi me patriotët dhe intelektualët shkodranë. Më pas e transferuan në Durrës, ku punoi si kadi (gjykatës) dhe pastaj u zgjodh myfti.

Në Durrës u bashkua me patriotët: Nikollë Kaçorri, Abaz Celkupa, Seit Kertusha, Dr. Neki Libohova e shumë të tjerë.

Me formimin e klubeve "Vëllazëria" e "Bashkimi", Hafiz Aliu ka qenë anëtar i këtyre klubeve (1905-1909). Ai ka dhënë kontributin e tij për çështje me rëndësi kombëtare dhe përhapjen e mësimt të gjuhës shqipe në kushtet e asaj kohe.

Hafiz Aliu është dërguar gjithashtu si përfaqësues i Durrësit në "Kongresin e Dibrës" në korrik 1909. Këtu Hafiz Aliu e Dervish Hima fituan miratimin e të gjithë delegatëve për përkushtimin në çështjet kombëtare në planin arsimor, kulturor e politik.

Në vitin 1909, në zgjedhjet bashkiake, Klubi paraqiti kandidaturën e Hafiz Aliut. Ai ishte brumosur me idealet e Rilindësve tanë dhe kishte udhërrëfyes mësimet e Sami Frashërit nga ku kishte mësuar konceptet e qeverisjes së vendit. Ai ishte personi më i kompletuar për të përballuar detyrat e kryetarit të bashkisë.

Kështu u zgjodh kryetar i parë i Bashkisë së Durrësit në legjislaturën 1909-1912. Duke qenë gjithmonë konsekuent në lëvizjen patriotike, hidhte bazat e administratës shqiptare edhe në fushën e drejtësisë.

Pas dështimit për ngritjen e flamurit në Durrës më 24 nëntor 1912, si kryetar Bashkie nënshkroi aktin e përfaqësimit për delegatët e Durrësit, që do të shkonin në kuvendin e Vlorës.

Akt i rëndësishëm i qytetarisë durrësake, pas largimit të Ismail Qemalit për në Vlorë, që ai i Hafiz Ali Podgoricës, Kryetar i parë i Bashkisë dhe personalitet i shquar, i cili më 26 nëntor 1912 ngriti me dorën e tij Flamurin Kombëtar në Pallatin qeveritar të Durrësit.

Menjëherë pas këtij akti madhor patriotët durrësakë nën drejtimin e Hafiz Aliut më 27 nëntor 1912 firmosën telegramin Nr. 3300 dërguar të gjithë qyteteve me rëndësi të Shqipërisë për shpalljen e pavarësisë në Durrës (shpallën independencën në emër të kombësisë tonë të shtrenjtë e të gjithë Shqipërisë).¹

Njëkohësisht iu dërguan memorandumet konsujve të Austrisë, Francës dhe përfaqësuesit italian në Durrës. Në dokumentet historike që ndodhen në Arkivin e Shtetit (Fondi i pavarësisë) shkruhet:

"Hafiz Ali Podgorica (1855-1929) më 26 nëntor 1912, me cilësi si kryetar Bashkie, pati nderin e posaçëm me ngritë

1. Bebeziq, Danish, "Kontributi i Durrësit për shpalljen e pavarësisë. Akte të Rilindjes Kombëtare".

me dorën e vet Flamurin e Shqipërisë në pallatin qeveritar të Durrësit".²

Administrata që kryesoi Hafiz Ali Podgorica më 1909-1912 për meritat e saj përbën faqe historie në jetën e qytetit të Durrësit. Është e kohës së tij dhe vula e parë e Bashkisë së Durrësit. Kjo detyrë lidhej padyshim me momentin historik që kalonte qeveria e përkohshme e Vlorës.

Për veprimtarinë patriotike atdhetare Hafiz Aliu gjithë jetën e tij ia kushtoi veprimtarisë për të mirën e vendit në organizimin e administratës shtetërore, si dhe në planin arsimor, kulturor e politik. Për figurën intelektuale janë zhvilluar disa mbledhje ku janë dhënë disa kumtesa për veprimtarinë e tij.

Në atë kohë Esat Pashë Toptani, duke shfrytëzuar postin e tij si ministër i brendshëm i Qeverisë së Vlorës, në vitin 1913, e përdori xhandarmërinë për interesat vetjake, ambicioze kundër Qeverisë Kombëtare. Hafiz Aliu e kuptoi qëllimin e tij politik pro-serb. Bashkë me patriotët e tjerë durrësakë u larguan me familjet e tyre nga Durrësi. Për dënim u janë plaçkitur shtëpitë e tyre. Po e njëjta gjë ndodhi në vitin 1924 kur Esat Pasha erdhi për të dytën herë në Durrës.

Hafiz Aliu ishte përkrahës i mendimeve demokratike të Fan Nolit.

Gjatë regjimit të Zogut dëbohet në Kavajë në vitin 1926. Ka vdekur në vitin 1929 duke lënë familjen në gjendje të vështirë ekonomike.

Në vitin 1992, Hafiz Ali Podgoricës i jepet nga Presidenti i Republikës z. Sali Berisha titulli "Urdhri i Klasit të I-rë" për veprimtari patriotike me motivacionin: "Si figurë intelektuale, i dalluar në organizimin e luftës për çlirim kombëtar, për ngritjen e Flamurit në Durrës (26 Nëntor 1912) dhe për organizimin e administratës shtetërore".

Më 16.10.1996, këshilli bashkiak i qytetit të Durrësit i jep Hafiz Ali Podgoricës (pas vdekjes) titullin: "Qytetar nderi i qytetit të Durrësit" me motivacionin: "Intelektual dhe patriot i shquar. Si delegat i Durrësit në Kongresin e Dibrës, ka luftuar me sukses synimet xhonturke. Bashkëpunëtor i Ismail Qemalit, me porositë e të cilit ngriti Flamurin Kombëtar në Durrës më 26 Nëntor 1912. Kryetari i Parë në Bashkinë e Durrësit në vitet 1909-1912".

Më 16-17 gusht 2003, nga Bashkia e Durrësit e Shoqata "Durrësi", i akordohet Hafiz Ali Podgoricës (pas vdekjes) titulli: "Simbol i Qytetit - Kryetarit të Parë të Bashkisë së Durrësit, intelektualit të shquar që organizoi administratën shtetërore, patriotit të flaktë që më 26 Nëntor 1912 ngriti Flamurin e Pavarësisë në Durrës".

Më 26 nëntor 2005, nga Bashkia e Durrësit dhe Shoqata "Durrësi" i akordohet Hafiz Ali Podgoricës titulli: "Mirënjohje e qytetit të Durrësit" me motivacionin: "Për kontributin që ka dhënë për Pavarësinë e shtetit shqiptar dhe për ngritjen e Flamurit Kombëtar Shqiptar në qytetin e Durrësit më 26 Nëntor 1912".

Më 26 nëntor 2008 u bë inaugurimi i përmendores së kryebashkiakut të parë të Durrësit, Hafiz Ali Podgorica 1909-1912.

2. Hidri, Sali, "Durrësi 1900-1939", Arkivi i Shtetit (Fondi i Pavarësisë), Dosja e Hafiz Ali Podgoricës.

XHAMIA E Muradies, VLORË

Nga qyteti mesjetar dhe mjaft i përmendur i Vlorës, sot në qendër të tij ruhet vetëm xhamia e Muradies. Gjatë shekujve XV-XVI-të Vlora ishte qendra e banuar më me rëndësi për perandorinë osmane në Shqipëri, falë pozitës që kishte porti i Vlorës në detin Adriatik.

Xhamia e Muradies përbëhet nga salla e lutjeve dhe minarja, ndërsa nga portiku i dikurshëm, në anën veriore, siç mendon Kiel, ruhen bazamenti dhe gjurmët në mur të strukturave të drunjtja të xhamisë. Në sallën e lutjeve, me përmasa 8,70 x 8,55 m, hyhet nga porta e vetme që ndodhet në anën veriore, e cila mbulohet me një hark të ulët. Shpatullat e portës, si dhe pragu i saj, janë prej

gurësh gëlqerorë të mermerizuar një copë, ndërsa harku është ndërtuar me gurë të vendosur sipas rrezeve, që në faqet e kontaktit ndërmjet tyre kanë nga një dhëmbëzim e një buzinë të punuar pak më thellë. Në secilin gur ka nga një rozetë të gdhendur që del pak mbi sipërfaqen e tij. Mbi hark ka një pjesë drejtkëndore, me thellime të shkallëzuara në formë kornize, në qendër të së cilës është një pllakë, aty ku zakonisht është mbishkrimi ndërtimor, vend i cili është me përmasa 120 x 59 cm. Si porta, ashtu dhe pjesa mbi të prej guri të gdhendur, janë pak më brenda faqes, anash tyre muri është i gdhendur dhe formon një kornizë kufizuese, me profil të shkallëzuar,

karakteristikë për portalet e hyrjeve të xhamive. Në të dy anët e portës janë dy dritare drejtkëndore. Ato janë pak në brendësi të murit dhe kanë, në pjesën e sipërme, një nike, të mbuluar me gurë që dalin të shkallëzuar, njëri ndaj tjetrit. Shpatullat dhe mbulesat e dritareve janë me gurë të skuadruar. Pjesa mbi arkitraun është punuar në mënyrë të rregullt dhe aty shohim fragmente të një harku shkarkues me tulla.

Përballë portës së hyrjes, në sallën e lutjeve, është mihrabi me prerje gjysmërrethi, me stalaktite në pjesën e sipërme dhe i rrethuar nga një kornizë drejtkëndore. Në të djathtë të tij ndodhet minberi. Salla ndriçohet mirë nga dritare të shumta në të gjitha faqet. Me përjashtim të faqes veriore që kishte dy dritare, faqet e tjera kanë nga pesë dritare, të vendosura në tri radhë. Dy dritaret e poshtme janë shumë më të mëdha se të tjerat. Ato mbulohej me hark të mprehtë në formë fundlunde, të ndërtuara me gurë të skuadruar në formë pyke, që këmbehen me nga dy tulla. Harku rrethohet nga një shirit tullash pak të gdhendura për t'u dukur më të holla. Edhe dy dritaret e rreshtit të sipërm kanë forma të njëjta, por janë më të vogla. Pak më e vogël është dhe dritarja e vetme e rreshtit të tretë, që ndodhet ndërmjet trompave. Ajo ka një kornizë mbi harkun me tulla të vendosura për së gjati.

Në anën e jashtme, vëllimi kubik i sallës së lutjeve, është ndërtim mjaft i rregullt. Muratura, me gurë e tulla, është ndërtuar me mjeshtëri. Ajo përbëhet nga dy rreshta gurësh të skuadruar bukur, që këmbehen me dy rreshta tullash. Në nivelin e kulmit të harqeve të dritareve të rreshtit të dytë ka një kornizë të hollë prej gurësh të profilizuar. Mbi të, vëllimi kubik pëson ngushtim të lehtë dhe pjesët anësore i ka me çati trekëndëshe, më të ulëta në qoshet, mbi të cilat ndodhet tamburi dymbëdhjetëfaqësh, që vazhdon më drejtpërsëdrejti nga faqet anësore. Mbi pjesën e tamburit, të ndërtuar me gurë e tulla, kalon një kornizë horizontale, me gurë të gdhendur bukur, me profil të lakuar që, nga përmasat, tregon se duhet të ketë qenë fundi i muraturës. Kiel mendon se kjo përkujdesje është një veçanti e ndërtimeve të hershme dhe gjen paralele në dy ndërtime në Bullgari. Megjithatë, tamburi vijon dhe më lart, por i ndërtuar me gurë të çrregullt dhe duke përfunduar me një kornizë të thjeshtë. Ky ndryshim mund të shpjegohet, ngaqë tamburi është ngritur më vonë, pas një riparimi të çatisë.

Element mjaft me vlerë i xhamisë është minarja. Ajo përbëhet nga bazamenti shumëfaqësh; i ndërtuar me gurë të punuar, pjesa kalimtare; trungpiramide dhjetëfaqësh po me gurë të punuar, trupi i minares katërbëdhjetëfaqësh me gurë të punuar e fuga të holla, kazani me stalaktite në pjesën e poshtme dhe përfundimi i minares.

Minarja e xhamisë së Muradies është shumë cilësore. Mënyra e njëtrajtshme e ndërtimit, me gurë të gdhendur, e bën atë të duket një copë. Në mënyrë të veçantë bie në sy forma e mirë e ndërtimit, me gurë të punuar në formë stalaktitesh e pjesës së nxjerrë konsol të kazanit, një ndër shembujt më të arritur në vendin tonë. Pjesa e ulët mbi kazan nuk është në nivel të njëjtë ndërtimi me trupin e minares dhe kazanin, çka na shtyn të mendojmë

se duhet t'i takojë një rindërtimi.

Duke u nisur nga format arkitekturore, trajtimi i përgjithshëm i pjesëve të veçanta (minare, portali i hyrjes dhe teknika e ndërtimit), mendojmë se xhamia e Muradies duhet të jetë ndërtuar në mesin e shek. XVI. Më tej, duke u mbështetur te Çelebiu, kemi bërë hipotezën se kjo xhami mund të jetë ajo që ka ndërtuar në Vlorë, Sulltan Sulejmani në vitin 1542, veç asaj në kala. Për këtë jemi nisur nga fakti që Çelebiu, jashtë kalasë së Vlorës në qytet përmend vetëm një xhami të mbuluar me plumb (domethënë me kupolë), atë të Sulltan Sulejmanit, e cila, sipas mbishkrimit, ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1542.

Sipas tij, kjo xhami minaren e kish të shembur, ndërsa xhamitë e tjera, ajo e Mumçi-Zadesë dhe ajo e Hysen Agait në Tabake, janë të mbuluara me tjegulla, domethënë me çati druri. Gjithashtu, rezulton se deri në vitet '20 të shekullit tonë xhamia quhej Kursunli xhami (domethënë e Plumbit) dhe u riemërua e Muradijes. Emri i ri lidhet me lagjen e quajtur Muradije ku ndodhet xhamia. Nëse do t'i referohemi ngjarjeve historike, do të shohim se sulltan Sulejmani ka qenë në Vlorë në vitin 1537, në rrugën për në Korfuz, kur përgatitej për ekspeditën e Puljes².

Për datimin e kësaj xhamie, me interes është dhe teknika e ndërtimit të mureve, e veçantë për vendin tonë, që na kujton xhamitë e Stambollit të ndërtuara nga arkitekt Sinani, si xhamia e Ibrahim Pashës, xhamia e Zal Mahmut Pashës, (1560-1566) si dhe xhami të tjera në periferi të Stambollit. Gjithashtu, duhet thënë se nga vështrimi i mureve nuk na duket i drejtë mendimi i shprehur disa herë se xhamia e Muradies është kishë e kthyer në xhami. Muret janë të gjitha të një dore dhe mbi sipërfaqe të tokës nuk ka ndonjë gjurmë të tillë. Përfundimin e konfirmon dhe Kiel³.

Në literaturë janë shprehur mendime të ndryshme për kohën e ndërtimit të kësaj xhamie. Kiel mendon se kjo xhami duhet të jetë ndërtuar rreth vitit 14304, ndërsa Gjergj Frashëri dhe Sulejman Dashi janë shprehur fillimisht, se duhet të jetë ndërtuar ndërmjet viteve 1421-14575, me sa duket, të nisur nga emri i saj Muradie, sepse këto vite janë koha e sundimit të Sulltan Muratit të II. Këtë mendim e kemi kundërshtuar të nisur përdorimi i trompave parabolike në qoshe dhe jo trekëndësha, si dhe nga format e zhvilluara arkitektonike⁶.

Më vonë këta dy studiues u shprehën se xhamia e Muradies është ndërtuar nga arkitekt Sinani, gjatë pjesëmarrjes së tij të supozuar, në ekspeditën e vitit 1537 të Sulltan Sulejmanit⁷. Tashti së fundi atë e përsërisin këtë tezë, duke e lidhur mbishkrimin e vitit 1542 me xhaminë e Pashallarëve. Edhe Kiel shprehet se ka mundësi të jetë një vepër e hershme e Sinanit⁸.

1. Evlia Çelebi..., 139v. Ky mbishkrim deri vonë ndodhej në xhaminë e Pashallarëve, shih V. Buharaja, Mbishkrimet...

2. Evlia Çelebi..., 139v.

3. M. Kiel, Ottoman..., shen. 58.

4. M. Kiel, Aspects... 545.

5. Gj. Frashëri – S. Dashi, "Karakteristika..." 42.

6. A. Meksi, "Ndërtimet..." 201, shen. 51.

7. Gj. Frashëri – S. Dashi, "Ku lindi Sinani i madh", Nëntori 2, 1981, 196.

8. Marrë me shkurtime nga libri "Xhamitë e Shqipërisë, historia, arkitektura, shek. XV-XIX.



ROLI I “DRITËS ISLAME” NË NDËRGJEGJËSIMIN E GRUAS

Në faqet e gazetës, pastaj revistës “Dritës Islame”, janë botuar materiale të shumta e me tematikë të larmishme, si studime, analiza, portrete, çështje fetare e edukative, diskutime, reportazhe e kronika, përmes të cilave shpalosen vlera për edukimin shpirtëror islam për dashuri e përgjegjësi kombëtare.

Midis tyre nuk janë lënë pa përmendur edhe çështjet që kanë të bëjnë me figurën e gruas dhe rolin e saj në shoqëri. Gazeta/revista “Drita Islame” në çdo numër të saj ka pasur hapësirë për gruan. Kjo do të thotë që ajo e ka parë shumë të domosdoshme që çështjet e gruas të trajtohen denjësisht dhe shoqëria mbarë të ndërgjegjësohet. Jo vetëm kaq, por “Drita Islame” ka shkruar për vajzat dhe gratë duke u kujdesur që të nxjerrë në pah vlerat më të bukura të tyre, të mbrojtë të drejtat dhe të nxisë emancipimin. Pra, “Drita Islame” me rubrikën e gruas ka dashur të ndriçojë dhe të zgjojë vetëdijen e lartë për lidhjet e shumëfishta të misionit hyjnor të gruas dhe të rolit të saj në përparimin e shoqërisë.

Në materialet e shkruara rreth gruas, kuptohet lehtë se gratë dita ditës po fitojnë gjithnjë e më shumë të drejta, gjithashtu, gruaja në ditët e sotme ka më shumë rol dhe është më e integruar në jetën sociale. S’ka dyshim që kontribut të rëndësishëm në këtë dimension ka pasur edhe kjo revistë, e cila asnjëherë nuk është pajtuar me mendimin e gruas së mbyllur, që nuk gjendet prezente edhe jashtë shtëpisë dhe që nuk përfshihet në aktivitete të gjera. “Drita Islame” është munduar ta ushqejë gruan shqiptare në përgjithësi dhe atë myslimane në veçanti me mesazhin e rolit, misionit dhe detyrave të vërteta të saj. Modeli që ajo ofron për emancipimin e gruas, i njeh asaj të drejtën dhe detyrën e të qenit pjesë aktive e shoqërisë, por gjithashtu ruan natyrën e pastër femërore me të cilën Zoti e ka krijuar femrën.

Çështje në lidhje me gruan myslimane që përbëjnë dyshime dhe paragjykitime edhe nga mbarë shoqëria, “Drita Islame” i ka ngarkuar vetes misionin e rëndësishëm për t’i qartësua ato, duke i argumentuar në format më të ndryshme. E ka bërë këtë duke ruajtur kornizën fetare por edhe me argumentin e arsyes. Një nga këto ka qenë dhe është ende sot e kësaj dite çështja e veshjes së gruas myslimane. Në një nga këto shkrime të titulluar “Mbulesa petku i devotshmërisë”, thuhet: “Veshja jo e përshtatshme në rrugë apo në punë sjell prishjen e moralit njerëzor. Feja Islame nuk i ka burgosur gratë dhe nuk ua ka hequr liritë, por me anë të veshjes ajo i ka kufizuar disi për të ruajtur nderin, e veç kësaj i ka lënë të lira brenda kufijve të ndershmërisë. Feja islame nuk njih veshje të posaçme për gruan. E sheh të arsyeshme që kjo (veshja) të jetë në varësi të zakoneve, traditave”.

Një ndër çështjet kryesore të trajtuara në faqet e saj është edhe edukimi i gruas. Për nevojën e edukimit të grave, “Drita Islame” shtron këto arsye: Gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së globit tokësor, prandaj duke u

edukuar ato, është edukuar gjysma e racës njerëzore, kalimi i një jete të lumtur të çiftit bashkëshortor. Edukata familjare që buron nga nëna, trashëgohet në të gjithë të ardhmen e racës njerëzore. Nga një nënë e edukuar kalohet në një shoqëri të edukuar.

Lidhur me këto, pozita e gruas në familje zë një vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste. “Drita Islame” vlerëson cilësitë e gruas për edukimin e fëmijëve, respektin që duhet të kemi për të si nënë, bashkëshorte, vlerëson dhe orienton pajisjen e saj me kulturë.

Gjatë 30 viteve të “Dritës Islame”, e shohim gruan si pjesëmarrëse aktive në shoqëri. Gjatë viteve të para të botimit të saj, është ngritur edhe shoqata e parë e grave myslimane. Veprimtaritë fetare ndiqeshin në mënyrë të organizuar dhe me shumë interes. Të gjitha këto aktivitete, ajo i ka pasqyruar në faqet e saj, duke dhënë kështu mesazhin e fortë që gruaja duhet të jetë e tillë.

Ky aktivizim i gruas myslimane, me kalimin e viteve, ka ruajtur vrullin dhe është rritur në një mënyrë konstante. Kështu, gjatë viteve të fundit, në revistën “Drita Islame” vërejmë një pjesëmarrje më të gjerë të gruas, dhe aktivitetet që organizohen në lidhje me të, pasqyrohen në këtë revistë. Në këtë mënyrë, kjo revistë i ka dhënë vazhdimisht mbështetjen maksimale organeve përfaqësuese të gruas, si Zyra e Gruas në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë, po ashtu edhe shoqatave të ndryshme të gruas, numri i të cilave është rritur ndjeshëm.

Rritja e numrit të aktiviteteve në lidhje me gruan dhe të drejtat e saj, patjetër që janë rezultat edhe i ndërgjegjësimit me anë të publikimeve në revistën “Drita Islame”, e cila, kur shumë qarqe islame madje kundërshtonin pjesëmarrjen e gruas në një rreze më të gjerë, ka kërkuar vazhdimisht që ajo të jetë e pëfshirë në çdo sferë të jetës. Falë Zotit, sot e kësaj dite, të gjithë myslimanët në Shqipëri i gjejnë edhe më të ndërgjegjësuar në këtë çështje dhe më bashkëpunues. Pa dyshim që roli i revistës “Drita Islame” në realizimin e këtij synimi dhe zgjidhjen e këtyre ngërçeve është i pamohueshëm.

Pra, te kjo revistë gjejmë një qasje mjaft bashkëkohore, e cila vendos një ekuilibër mes roleve të gruas dhe jetës së saj fetare, si dhe kumton fuqishëm që ky ekuilibër do t’i japë asaj vendin e merituar në shoqëri. Revista “Drita Islame” kujdeset t’u japë rëndësinë e duhur edhe problematikave sociale të kohës, duke u përpjekur t’i nxjerrë gratë nga vështirësitë dhe t’iu njohë të drejtat e tyre.

Si përfundim, mund të themi që organi i shtypit “Drita Islame”, i ka frymëzuar gratë që të jenë nëna të mira, bashkëshorte besnike, por edhe aktive në të gjitha fushat e shoqërisë. Urojmë që kjo revistë të korrë vetëm suksese në misionin e saj të artë dhe të jetë burim orientimi për gruan në të gjitha dimensionet e saj.



Sheqer
apo
Yndyrë

Diabeti është një nga rreziqet më serioze për shëndetin publik sot. Kombet e Bashkuara e shpallën diabetin si një kërcënim global në vitin 2007 për të theksuar se sa i përhapur dhe shkatërrues ishte bërë ai.

Diabeti është një nga sëmundjet më të vjetra të njohura, madje përmendet në tekstet e lashta egjiptiane, indiane dhe kineze. Tekstet e lashta egjiptiane i përkufizonin diabetikët si "...aq të etur sa që po të pinin të gjithë ujin e Nilit, etja e tyre nuk do të shuhej akoma". Tekstet e lashta indiane dhe kineze përmendin insektet dhe mizat që grumbullohen mbi urinën e shkarkuar nga diabetikët.

Shkencëtarët e lashtë Al-Razi dhe Ibn Sina (Avicena) bënë gjetje të rëndësishme rreth diabetit. Al-Razi e lidhi diabetin me obezitetin dhe zakonet e të ushqyerit. Ibn Sina specifikoi se asnjë ind apo organ nuk mund t'i mbijetonte diabetit, i cili gjithashtu shkaktoi disfunksione seksuale dhe gangrena.

Ka dy probleme kryesore që shfaqen në lidhje me diabetin:

Lloji 1: Mungesa e sekretimit adekuat të hormoneve të insulinës nga pankreasi.

Lloji 2: Inde jofunksionale dhe rezistente ndaj insulinës, pavarësisht nga sekretimi adekuat i insulinës.

Këto dy lloje nuk bashkëjetojnë në një pacient. E para ndodh kryesisht tek fëmijët ose të rinjtë. E dyta ndodh kryesisht tek të rriturit që preken kryesisht nga diabeti për shkak të obezitetit. Diabeti mund të zbulohet nga një rritje e sheqerit në gjak dhe urinë. Nëse sheqeri në gjak tejkalon një kufi të caktuar, atëherë ai do të shfaqet në urinë.

Diabeti shfaqet nga një rritje e sheqerit në gjak dhe urinë. Ai jo vetëm që dëmton ekuilibrin e sheqerit në trup, por gjithashtu prish metabolizmin e yndyrës dhe proteinave. Qelizat nuk arrijnë të absorbojnë sheqerin, yndyrat dhe aminoacidet, gjë që rrit nivelin e tyre në gjak. Mund të thuhet qartë se komplikimet e diabetit vijnë nga rritja e niveleve të yndyrës dhe jo e sheqerit në gjak. Përveç kësaj, çrregullimet diabetike në metabolizmin e yndyrës shkaktojnë shfaqjen vdekjeprurëse të niveleve të acidit në gjak (acidozë) dhe ngurtësim vaskular (arteriosklerozë). Ulja e aftësisë së sintezës së proteinave tek pacientët me diabet afatgjatë çon në varfërim të indeve dhe mosfunksionime të shumta qelizore. Rrjedhimisht, diabeti me origjinë nga mungesa e insulinës prish metabolizmin e yndyrave dhe proteinave së bashku me metabolizmin e sheqerit.

Gjendra pankreatike është vendi ku insulina lirohet në trupin tonë. Heqja kirurgjikale e kësaj gjëndre tek kafshët eksperimentale tregoi se nivelet e yndyrës në gjakun e tyre rriteshin më shpejt se nivelet e sheqerit. Tek diabetikët, dhjami rreth barkut dhe ijeve derdhet në qarkullimin e gjakut, duke çuar kështu në një rritje të niveleve të yndyrës neutrale (triglicerideve) dhe kolesterolit në gjak së bashku me një akumulim të yndyrës në mëlçi.

Nëse yndyrat mbeten në qarkullimin e gjakut pas ushqyerjes, atëherë ato fillojnë të ngjiten në muret e arterieve, gjë që mund të shkaktojë bllokim dhe ngurtësi

në enët e gjakut. Kjo është arsyeja pse është thelbësore transferimi i yndyrës nga qarkullimi i gjakut në depozitimin e yndyrës rreth barkut dhe ijeve me anë të sheqerit dhe insulinës. Yndyra e ruajtjes quhet triglicerid. Një molekulë trigliceride përmban tre njësi vaji dhe një njësi sheqeri. Prandaj, pothuajse 25% e depozitimit të yndyrës është sheqer. Pa furnizim me sheqer nga qarkullimi i gjakut, si në rastin e diabetit, qelizat të cilat si parazgjedhje depozitojnë yndyrë nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë. Diabeti, si një çrregullim serioz, madje e ndryshon këtë mekanizëm: yndyrat fillojnë të lëvizin nga depozitimi në qarkullimin e gjakut, jo nga qarkullimi i gjakut në ruajtje. Kjo shkakton rritjen e të gjitha yndyrave duke përfshirë trigliceridet, kolesterolin dhe fosfolipidet, dhe kjo është kur trupi bëhet edhe më i prirur ndaj sëmundjeve.

Obeziteti ose dieta me bazë yndyre të tepruar është një nga shkaqet kryesore të diabetit. Njerëzit janë tashmë mbipeshë përpara se të shfaqet çrregullimi. Megjithatë, nëse nuk marrin trajtim pas fillimit të diabetit, diabetikët fillojnë të humbin peshë shpejt dhe më shumë seç duhet. Kjo ndodh sepse yndyrnat relativisht të padëmshme në ruajtje fillojnë të treten në qarkullimin e gjakut.

Sheqer apo yndyrë?


Njësia e quajtur acidozë metabolike, e cila mund të shkaktojë koma dhe vdekje të diabetikët, në fakt e ka origjinën nga rritja e produkteve yndyrore në gjak dhe mëlçi, jo nga rritja e sheqerit në gjak. Tek diabetikët, kur qelizat nuk mund të përdorin sheqerin, ata përdorin energjinë e tyre nga yndyrat. Rrjedhimisht, yndyrnat e depozituara fillojnë të treten dhe derdhen në qarkullimin e gjakut. Yndyrnat që udhëtojnë në mëlçi përmes qarkullimit të gjakut kthehen në substanca acidike të quajtura trupa ketonike (acidi acetoacetik, acidi beta hidroksi butirik dhe acetoni). Këto substanca acidike kalojnë nga mëlçia në qarkullimin e gjakut dhe merren nga qelizat për të plotësuar nevojat e tyre për energji. Sidoqoftë, të diabetikët, qelizat nuk mund t'i shndërrojnë këto produkte yndyrore acidike, d.m.th., trupat ketonikë, në energji. Acidi oksaloacetik nga sheqernat kërkohet për ciklin e prodhimit të energjisë të quajtur cikli i Krebsit. Me pak fjalë, njerëzit kanë nevojë për sheqer për të djegur yndyrën. Kjo është arsyeja pse është normale që disa njerëz të ndiejnë nevojën për të ngrënë diçka të ëmbël pas një vakti të yndyrshëm, sepse ata kanë nevojë për sheqer për të tretur yndyrat në gjakun e tyre. Meqenëse qelizat nuk mund të nxjerrin sheqer nga gjaku, ato vuajnë nga mungesa e acidit oksaloacetik për të kthyer yndyrat në energji. Yndyrnat dhe trupat ketonikë grumbullohen në qarkullimin e gjakut dhe, duke qenë se trupat ketonikë janë acidikë, ato mund të shkaktojnë që nivelet e aciditetit të rriten në nivele jashtëzakonisht të larta në qarkullimin e gjakut, gjë që mund të rezultojë në koma apo edhe vdekje të papritur. Substancat vdekjeprurëse këtu nuk janë sheqernat, por trupa ketonike, ose produktet yndyrore.

Anomalia më e rëndësishme e shkaktuar nga diabeti është ngurtësia vaskulare (arterioskleroza), e cila nuk vjen nga sheqeri i tepërt, por nga yndyra e tepërt në qarkullimin e gjakut. Tek diabetikët, nivelet e triglicerideve, kolesterolit dhe fosfolipideve rriten në qarkullimin e gjakut për arsye të përshkruara më sipër. Yndyrnat në qarkullimin e gjakut nuk qarkullojnë lirshëm; ato barten në mikropika të quajtura lipoproteina. Mëlçia ngarkon yndyrnat në "kamionë" lipoproteinash dhe i vendos ato në qarkullimin e gjakut për t'u përdorur nga qelizat. Megjithatë, për shkak të mungesës së insulinës tek diabetikët, lipoproteinat nuk mund të zbrazin ngarkesat e tyre të yndyrës në depot e yndyrës. Lipoproteinat më të rrezikshme për ngurtësimin vaskular klasifikohen si LDL (lipoproteina me densitet të ulët) dhe HDL (lipoproteina me densitet të lartë). HDL-të janë si kamionë bosh të prodhuar posaçërisht nga mëlçia, e cila i dërgon ato në qarkullimin e gjakut. Ndërsa qarkullojnë në qarkullimin e gjakut, këta "kamionë" mbledhin yndyrën dhe kolesterolin e mbërthyer në muret e venave si magnet dhe, pasi pastrojnë muret e brendshme të venave, kthehen si kamionë të ngarkuar përsëri në mëlçi. Duke përdorur "kamionët" HDL, mëlçia heq yndyrën nga qarkullimi i gjakut. Mjekët vlerësojnë nivelet e LDL dhe HDL ndërsa kontrollojnë pacientët e tyre për rrezikun e ngurtësimit vaskular. Një rritje ose ulje e shkallës së LDL nuk është e mirë për pacientët, ndërsa niveli i lartë i HDL është një shenjë pozitive.

Shkaqe të tjera të ngurtësimit vaskular përfshijnë mungesën e aktivitetit fizik, zakonet e jetës sedentare dhe të punës, pirjen e duhanit, konsumimin e alkoolit, mbipeshën, mbikonsumimin e ushqimeve të pasura me yndyrë shtazore dhe presionin e lartë të gjakut. Ngurtësia vaskulare është një nga shkaqet kryesore të dilatimit kardiak (zembrës së zmadhuar), insuficiencës kardiake (dështimi i zembrës) dhe sulmit në zemër. Përveç këtyre komplikimeve, ngurtësimi vaskular mund të çojë gjithashtu në presion të lartë të gjakut, hemorragji cerebrale, paralizë, dështim të veshkave dhe ishemi vaskulare në tru ose në organe të tjera. Nëse nuk trajtohen, pothuajse të gjitha këto çrregullime rezultojnë në vdekje.

Diabetikët duhet të ndjekin një regjim efektiv trajtimi për të mbajtur nën kontroll nivelin e sheqerit në gjak. Dihet se agjërimi është i dobishëm për kontrollin e sheqerit në gjak. Nëse sheqeri në gjak është normal, yndyrnat në qarkullimin e gjakut do të lëvizin në depo dhe nuk do të dëmtojnë enët e gjakut. Tek të moshuarit dhe diabetikët obezë, çdo dëm që vjen nga sheqeri i lartë në gjak nuk del menjëherë në sipërfaqe dhe kjo mund të mashtrojë pacientët. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të kontrolloni sheqerin në gjak në mënyrë që të mos bini në këtë gabim. Trajtimi nuk duhet neglizhuar kurrë. Nëse sheqeri në gjak mund të reduktohet në mënyrë efektive, nuk është e drejtë të hiqni dorë plotësisht nga sheqeri në dietë. Siç u përmend më herët, njerëzit kanë nevojë për sheqer për ruajtjen e yndyrave ose konvertimin e yndyrave (ose ketoneve) në energji në ciklin e Krebsit.

Me pak fjalë, yndyra e lartë në gjak është një shkak më serioz i diabetit sesa sheqeri i lartë në gjak.



Pika që shpëtoi një njeri

I Gjithëmëshirshmi i ka mësuar atij (njeriut) të folurit e qartë.
(Surja 55 : 1, 4)


Ju, të dashur fëmijë, me siguri i përdorni drejt shenjat e pikësimit – pikën, presjen, pikëpresjen, dy pikat, pikëpyetjen, pikëçuditjen etj. Shumë mirë! Bukur! Sepse ndryshe, nuk do të thoshit atë që dëshironit. Ja, t’ju japë xhaxhi një shembull. Kur habitemi për diçka të lartë, themi “Sa e lartë është” dhe në fund vëmë pikëçuditjen (!). Po kjo fjali mund të përdoret për të pyetur: “Sa e lartë është” dhe në fund vëmë pikëpyetjen. Pra, dy mendimet tona shprehen njëlloj me fjalë. Ç’i dallon ato? Vetëm shenja e pikësimit – pikëçuditja dhe pikëpyetja dhe kur flasim, – zëri ynë, ulja dhe ngritja e tij. Pra, mos e ngatëroni pikëpyetjen me pikëçuditjen! As presjen me pikëpresjen! Kur vëmë presje, bëjmë pushim të shkurtër në lexim; kur vëmë pikëpresje, pushimi ynë është më i gjatë. Por, jo sa te pika. Te pika pushimi është i gjatë. Pika, siç e dini, dallon pohimin nga pyetja e nga habia; shihni, p.sh., fjalitë: Ai nuk vjen sot nga Durrësi. Ai nuk vjen sot nga Durrësi? Ai nuk vjen sot nga Durrësi!

Për përdorimin me vend të pikës e në përgjithësi, të shenjave të pikësimit, xhaxhi do t’ju tregojë një rrëfenjë të hershme. Por më parë, do të doja t’ju thosha dy fjalë për historinë e shenjave të pikësimit. Pikësimi është shpikje e kohëve të vonshme. Ju, mbase nuk e dini: Shkrimi e ka zanafillën nga vizatimet në rrasa guri etj. gjatë gjysmës së dytë të shekullit të katërt para erës së re. Pra, mjaft herët. Por as format më të thjeshta të shenjave të pikësimit nuk u përdorën deri vonë. Shenjat e pikësimit, që përdoren sot janë zhvilluar shumë ngadalë, madje, ato nuk u vendosën plotësisht deri në shekullin XVI.

Tani t’ju tregoj atë rrëfenjë? Po? Mirë, atëherë. Po ju tregoj, siç e kam dëgjuar nga mësuesi, kur kam qenë edhe unë kështu i vogël sa ju. Mbase mend që patëm bërë diktim dhe disa nxënës kishin vënë gabim disa shenja pikësimi. Ndryshe nga herët e tjera, mësuesi nuk i mori një për një fletoret e të na thoshte gabimet. I vuri ato në tryezë. Pastaj, largoi pak karrigen e doli përpara klasës. “Dëgjoni me vëmendje!, – tha mësuesi. Do t’ju them një rrëfenjë. Do ta dëgjoni rrëfenjën, – vijoi ai, – pastaj do ta ritregoni”. Dhe nisi: “Na kishte qenë njëherë një mbret. Një mbret mizor, shumë i egër e shumë i pamëshirshëm, vrasës e gjakatar. Mbreti kishte dënuar me vdekje sa e sa njerëz të varfër, të cilët kishin kërkuar të drejtat e tyre, kishin kërkuar tokë e bukë për vocërrakët e tyre. Ishte dënuar e priste ditën e pushkatimit edhe një burrë i gjatë, i dobët e i thatë, por me një fytyrë e me një buzëqeshje të ëmbël. Mbërriti fermani i mbretit të shkruasi (tani, shkruasi i themi sekretar ose sekretare, kurse fermani ishte urdhër me shkrim shkresë). Shkruasi, pra, sekretari do ta rishkruante

dhe do ta përcillte urdhrin te skuadra e pushkatimit. Urdhri thoshte: “Falje e pamundur. Të pushkatohet!”. Kuptohet, – vijoi mësuesi, – burri i gjatë, i mirë e i pafajshëm kishte kërkuar që mbreti ta falte. Po ku falte mbreti! E tërë klasa lëshoi një ofshamë të gjatë, një “oh” të thellë, që shprehte njëherësh dhembjen tonë dhe lutjen tonë, për të mos e vrarë atë njeri të mirë. Ne ishim përhumbur e hutuar. Ai ishte tregim, por ne na dukej se njeriu që do të vritej, ishte diku afër, na dukej se mësuesi që dinte gjithçka, duhej ta njihte edhe mbretin dhe mund t’i lutej ta shpëtonte. E, me siguri, mbreti e dëgjonte fjalën e mësuesit, se ishte mësues! Në këtë çast e kishim harruar fare atë fjalinë e parë të mësuesit. “Na kishte qenë njëherë një mbret”, pra, që kishte qenë një mbret njëherë e një kohë, dikur, jo sot. Në të vërtetë, edhe mësuesi e kishte harruar se që tregim i moçëm, sepse që ngrysur i tëri në fytyrë. Me siguri, edhe ai përjetonte dhembjen për njeriun e dënuar. “E mori shkruasi fermanin e mbretit, – vijoi mësuesi, – dhe nisi ta kopjonte, pra ta shkruante përsëri, për t’ia përcjellë skuadrës së pushkatimit. Në ferman, – siç ju thashë, – shkruhej: “Falje e pamundur. Të pushkatohet!”. Mësuesi lëvizi pak përpara e ngriti kokën. “Shkruasi, – vijoi ai, – ndërroi vendin e pikës – nga nxitimi, apo ngase iu dhimbs njeriu i pafajshëm e deshi ta ndërronte, – këtë nuk e dimë, – shtoi mësuesi. Dhe shkruasi shkroi: “Falje. E pamundur të pushkatohet!”. Mësuesi shqiptoi fort fjalën pikë pas fjalës falje. Tani, mësuesi u çel në fytyrë, mori një pamje të gëzuar, i qeshi fytyra. “Dhe njeriu i pafajshëm nuk u pushkatua”, – tha mësuesi dhe mori frymë lirisht. Ne, e gjithë klasa, siç qemë të shtangur e të mbërthyer pas syve e pas buzëve të mësuesit, lëshuam në një zë një “oho” kënaqësie dhe fill, menjëherë, në çast, prapë në një zë pyetëm mësuesin: “Vërtet, mësues?! Vërtet?! Vërtet, për një pikë shpëtoi ai njeriu i mirë?” Ishim gati të vraponim të gjithë njëherësh e ta përqafonim mësuesin nga gëzimi, por në klasë nuk lëvizet. “Vërtet, – tha mësuesi, – prerazi, por ëmbël. Për një pikë. Nga një pikë”. Dolëm nga klasa, ashtu të magjepsur e të lumturuar, por edhe me merakun për të mos gabuar asnjëherë të shenjat e pikësimit.

Të dashur fëmijë! Ju do të bëheni shkrimtarë a mjekë, pilotë a shoferë, barnatorë a matematikanë, gazetarë a tregtarë, inxhinierë a deputetë, bujq a agronomë, veterinerë a sekretarë e kushedi çfarë tjetër, e pse jo, edhe udhëheqës. Allahu na ka mësuar të folurit e qartë. Por nuk mund të ketë të folur të qartë pa të shkruar të qartë. Prandaj i kini kujdes shenjat e pikësimit! Mos gaboni te pika! As te presja! Tek asnjëra shenjë a pikësimi!



BOTIMET KMSH



KALENDARI 2022
1443 - 1444 HIXHRI